

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDACIONI “LOGOS”
KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”**



**RAPORT VJETOR
PËR
VEPRIMTARINË E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË
TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”
PËR VITIN AKADEMIK
2021-2022**

Dhjetor, 2022

Pasqyra e Lëndës

HYRJE.....	2
PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	3
Akreditimi Periodik	4
Përmbyshja e Rekomandimeve të Vendimeve të Bordit të Akreditimit	5
Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për Akreditim	5
Veprimtaria e Vazhdueshme.....	5
Aktivitete Informuese	6
Aktivitete Vlerësuese	6
Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies ..	8
. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	23

HYRJE

Kolegji Universitar “LOGOS” ka hartuar politika, ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, Neni 103, pika 1 dhe në aktet rregullatore të brendshme, Kolegji Universitar “LOGOS” ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, siç është Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni, veprimtaria e të cilave mbështetet në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. Si përmbyshje e objektivit 2 të prioritetit strategjik 6: Sigurimi i Cilësisë, i evidentuar nga Kolegji Universitar “LOGOS” në planin e tij strategjik, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet me qëllim përmbyshjen e standardeve shtetërore të cilësisë. Ky sistem ndjek, vlerëson dhe monitoron procesin e mësimdhënies dhe koordinon e bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet për arritjen e një cilësie të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Pjesë e anëtarësisë në të dyja strukturat, është edhe përfaqësuesi i trupës studentore me një rol aktiv në proceset e cilësisë.

Veprimtaria për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” udhëhiqet nga Politika për Sigurimin e Cilësisë e hartuar në përputhje me Kodin e Cilësisë, siç udhëzon pika 5 e nenit 103 të Ligjit nr 80/2015 dhe i referohet një procesi të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi dhe përmirësimi të cilësisë së kolegjit e programeve që ai ofron duke u bazuar në kritere të brendshme e të jashtme. Menaxhimi i cilësisë, rritja e cilësisë, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i cilësisë, janë mjete nëpërmjet të cilave sigurohet cilësia në institucion. Sigurimi i cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” ka tre qëllime kryesore: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si pjesë e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, krijon, pasuron dhe mirëmban sistemin e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm dhe në bazë të rezultateve të monitorimeve të kryera, përgatit raporte të cilat u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera përdoren për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë paraqet raportin për veprimtarinë e kryer gjatë vitit akademik 2021-2022 sipas Rregullore së Sigurimit të Cilësisë (Kreu III, Neni 16, pika x).

Raporti përmban:

1. informacion të përmbledhur për veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj;
2. informacion për veprimtarinë e njësisë në përmbushje të objektivave të saj vjetore bazuar në zbatim të Politikave për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”;
3. informacion për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies (për semestrin e I-rë dhe të II-të) dhe për vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”;
4. mendime dhe rekomandime.

Raporti vjetor i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është hartuar bazuar në veprimtarinë e njësisë dhe në bashkëpunimin me Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë, në bashkëpunimin me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe në bashkëpunimin me njësitë bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë (*Kreu III, Neni 16, pika 2*), në përmbushje të misionit të saj, për planifikimin, drejtimin, organizimin dhe publikimin e veprimtarisë së kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimit të Kolegjit Universitar “LOGOS” për krijimin e kulturës së cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), argumenton në mënyrë të përmbledhur realizimin e objektivave vjetore për vitin akademik 2021-2022:

Akreditimi Periodik

1. Në përmbushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë,

Neni 16, pika 3/d:

A. NJSBC në kuadër të akreditimit periodik të programeve të ciklit të parë Bachelor:

- Bachelor në "Informatikë e Zbatuar"
- Bachelor në "Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore"
- Bachelor në "Menaxhim Turizmi"
- Bachelor në "Menaxhim Biznesi"

ka planifikuar e menaxhuar vlerësimin e brendshëm duke suportuar GVB-të përkatëse me asistencë teknike për kryerjen e vetëvlerësimit sipas procedurave të parashikuara në

Manualin e Cilësisë dhe duke bashkëpunuar me ASCAL për vlerësimin e jashtëm të këtyre programeve.

Përmbushja e Rekomandimeve të Vendimeve të Bordit të Akreditimit

- B. NJSBC ka monitoruar planin e veprimit të institucionit në përmbushje të rekomandimeve në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit (Nr. 58, datë 16.12.2021, “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, Kolegji Universitar “Logos”) dhe ka bashkëpunuar me strukturat përkatëse për përmbushjen e këtij plani.

Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për Akreditim

- C. Sipas planit të veprimtarisë të saj, NJSBC ka planifikuar vlerësimin e brendshëm gjatë vitit akademik 2022-2023 të programeve të studimit të ciklit të dytë:
- Master i Shkencave në Turizëm Religjioz (akreditim për herë të parë)
 - Master Profesional në Financë-Kontabilitet (akreditim periodik)
 - Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore (akreditim periodik)

duke asistuar në punën përgatitore të njësive bazë për procesin e vlerësimit të brendshëm dhe duke njohur strukturat e përfshira në këtë proces me modelin e ri të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bazuar në Kodin e ri të Cilësisë së Arsimit të Lartë (miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021).

Veprimtaria e Vazhdueshme

2. *Përmbushjen e përgjegjësisë të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/j, për vlerësimin e ecursisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”, NJSBC e ka kryer nëpërmjet bashkëpunimit përkatësisht me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe me njësitë bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS” duke përdorur metoda e instrumente të drejtëpërdrejta e të tërthorta vlerësimi, si:*

- pyetësorë të studentëve në fund të një cikli studimi të hartuar nga njësia bazë me qëllim përmirësimin e kurrikulës së ofruar;
- pyetësorë të studentëve të diplomuar, aktivë në tregun e punës anëtarë të LOGOS Almuni;
- pyetësorë për sugjerime mbi kurrikulën nga institucione publike dhe private me të cilat Kolegji Universitar “LOGOS” bashkëpunon për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve apo nga institucione ku janë të punësuar studentët e diplomuar;
- analizë e raporteve të vlerësimit të jashtëm të ekspertëve të fushës gjatë proceseve të akreditimeve të mëparshme të programeve të studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”.

Rezultatet e këtyre monitorimeve janë pasqyruar në raportin vjetor të Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe në raportet vjetore të njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Aktivitete Informuese

3. *Bazuar në Nenin 16, pika 3/l të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë*, NJSBC ka organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët e Kolegjit Universitar “LOGOS” për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet:
 - Zhvillimit të seancave të informimit të studentëve mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, treguesit e përdorur e mënyra e interpretimit të tyre;
 - Bashkëpunimit me ASCAL në trajnimin e stafit dhe studentëve për rëndësinë e zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS2022), si një nga mekanizmat kryesore të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë;
 - Trajnimit të stafit të ri akademik të përfshirë në strukturat e sigurimit të cilësisë për përfitimin e përvojës në këtë drejtim me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë gjithmonë e më të gjerë në institucion.

Aktivitete Vlerësuese

4. *Në përpushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/h & i*, NJSBC në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ka

organizuar vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies nga studentët dhe në fund të vitit akademik, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e veprimtarisë së njësive bazë dhe të shërbimeve për studentët duke përdorur paketën e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë të miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” bazuar në manualin e Cilësisë (sipas Kreut IV/*Procedura të sigurimit të cilësisë*, Neni 24/*Inicimi i vlerësimit*).

Në zbatim të Nenit 27 të Rregullores/*Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit*, NJSBC ka mbikëqyrur procesin për komunikimin dhe publikimin e vlerësimit, me qëllim garantimin se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë të jetë i përshtatshëm për qëllimin që ka, i arritshëm e i besueshëm.

Për këtë qëllim, janë hartuar raporte semestrale adresuar Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe gjithashtu drejtuesve të njësive bazë në të cilat pasqyrohet qartë metodologjia e vlerësimit, matësit e përdorur, rezultatet e pritëshme e interpretimi i tyre dhe sigurisht rezultatet e vlerësimit.

Në këto raporte evidentohen krahasimet e rezultateve semestrale për cilësinë e mësimdhënies ose krahasim në bazë vjetore për vlerësimin e veprimtarisë së departamenteve; evidentohen sugjerimet objektive të studentëve; adresohen mangësi e evidentuara dhe sugjerohen masat e nevojshme që duhet të merren në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Këto raporte janë përdorur për përmirësimin e performancës së personelit akademik sipas Nenit 28/*Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit*.

Refletimi mbi sugjerimet e dhëna nga këto raporte, janë shprehur përmes:

- trajnimeve të stafit akademik nga ekspertë të huaj e profesorë të Universiteteve partnere për metodat e mësimdhënies dhe organizimin e simpoziumeve shkencore me fokuse edukimin;
- mbështetjes së stafit për rritjen e formimit të tyre akademik e shkencor;
- rritjes së numrit të mobiliteteve të stafit akademik në universitet partnere në kuadër të programit Erasmus+, etj.

Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies në Semestrin e I-rë të vitit akademik 2021-2022

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj, si dhe të objektivave të parashikuara për kryerjen e veprimtarive monitoruese, vlerësuese e përmirësuese si një mënyrë e garantimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” bazuar në *Kreun III, Nenin 16 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë*, ka organizuar e monitoruar procesin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët, për lëndët e semestrit të parë të vitit akademik 2021-2022.

Ky proces u iniciua me përgatitjen e formularëve të vlerësimit për çdo staf akademik efektiv e të ftuar të angazhuar në programet e ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS” të cilat u postuan në klasat përkatëse të ngritura sipas programeve të studimit në platformën Microsoft Teams në nisje të javës së XIV të semestrit të parë. Çdo pedagog u vlerësua në të shumtën dy lëndë.

U monitorua vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në këtë proces dhe u ndërmorën disa masa nga ana e NJSBC-së për të siguruar një pjesëmarrje sa më të lartë të studentëve. Për këtë qëllim, është kryer një komunikim i drejtpërdrejtë me studentët për të evidentuar problematika të mundshme teknike si p.sh. mosaksesimi i llogarive në Microsoft Teams për plotësimin e formularëve. Si pasojë, u resetuan nga IT një numër i konsiderueshëm i llogarive të studentëve të evidentuar me këtë problematikë.

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit sipas secilit grup mësimor ishte:

Për Fakultetin Ekonomik:

Bachelor në Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizëm
Viti i parë – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 9 për 4 pedagogë, 8 për 1 pedagog dhe 7 për 2 pedagogë (në total të regjistruar 25 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 32%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 10 për 5 pedagogë dhe 9 për 1 pedagog (në total të regjistruar 19 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 52%.</i>
Viti i tretë: Bachelor në Financë-Kontabilitet – u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 10 për 3 pedagogë, 11 për 1 pedagog dhe 9 për 1 pedagog (në total të regjistruar 13 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 77%.</i> Bachelor në Menaxhim Turizëm – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 4 për 6 pedagogë dhe 3 për 1 pedagog (në total të regjistruar 4 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 100%.</i> Bachelor në Menaxhim Biznes – u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 7 për 4 pedagogë dhe 6 për 1 pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 44%.</i>
Master Profesional në Financë-Kontabilitet
U përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 8 për 3 pedagogë dhe 7 për 4 pedagogë (në total të regjistruar 13 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 61%.</i>
Programi Diplomë profesionale në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
Viti I – u përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 4 për 1 pedagog, 5 për 2 pedagogë dhe 6 për 1 pedagog (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 71%.</i>
Viti II – u përgatitën 5 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 5 formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 67%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara:

Bachelor në Informatikë e Zbatuar
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 9 për disa formularë, për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 11 dhe për 1 formular numri i vlerësimeve është 0. <i>Pjesëmarrja afërsisht 69%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 6 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 7 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 9. <i>Pjesëmarrja afërsisht 60%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 6 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 9 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 10. <i>Pjesëmarrja afërsisht 60%.</i>
Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 8 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 11. <i>Pjesëmarrja afërsisht 33%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 15 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 16. <i>Pjesëmarrja afërsisht 54%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë. <i>Pjesëmarrja afërsisht 29%.</i>
Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
U përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për 5 pedagogë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 14%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor:

Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor

Viti I - u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 6 formularët janë plotësuar nga 3 studentë (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja 100%.</i>
Viti II - u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 3 për 4 pedagogë, 4 për 2 pedagog dhe 5 për 1 pedagog (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 66%.</i>
Viti III - u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 5 formularët janë plotësuar nga 3 studentë (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja 100%.</i>
Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për 1 formular kishte 6 vlerësime, për 1 formular tjetër kishte 5 vlerësime, për 5 formularë kishte nga 3 vlerësime dhe për 1 formular kishte 2 vlerësime (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 66%.</i>
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe nuk kishte asnjë vlerësim (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 0%.</i>
Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencat Religjioze
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 5 pedagogë dhe për 5 formularët kishte vetëm nga 1 vlerësim (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për të 7-të formularët kishte nga 3 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja 60%.</i>
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 5 formularë kishte nga 4 vlerësime dhe për 1 formular kishte 3 vlerësime (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 66%.</i>
Master Shkencor në Turizëm Religjioz
U përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 1 formular kishte 3 vlerësime, për 2 formularë kishte nga 2 vlerësime, për 3 formular kishte nga 1 vlerësim, për 1 formular asnjë vlerësim (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 22%.</i>

Shënim: Duhet theksuar se numri i studentëve efektivë në disa grupe, është më i vogël se numri i raportuar si të regjistruar.

Nga ndjekja e procesit të vlerësimit të pedagogëve, u vunë re disa **problematika**:

- Angazhimi i pamjaftueshëm të studentëve në plotësimin e formularëve;
- Vështirësi në perceptimin e pyetjeve të pyetësorit.

Për problematikat e evidentuara, NJSBC-ja në bashkëpunim me Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe me njësitë bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”, ka ndërmarrë masa të ndryshme duke komunikuar me studentët verbalisht në auditore apo në mjete komunikimi të ndryshme (grupe të organizuara në what’s up apo Microsoft Teams) për zgjidhjen e vështirësive teknike të shfaqura tek studentët në lidhje me aksesimin e formularëve, për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për rëndësinë që mbart procesi; si për të kuptuar drejtë pyetjet e pyetësorëve për një vlerësim sa më objektiv, ashtu edhe për të arritur një pjesëmarrje sa më përfaqësuese të studentëve në procesin e vlerësimit. Në rastin e një grupi mësimor (konkretisht Viti i III-të i programit Bachelor Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore) është dashur të merret vendimi për shtyerjen e afatit të plotësimit të formularëve për përmbushjen e këtij qëllimi.

Përqindja e pjesëmarrjes totale të studentëve të Kolegji Universitar “LOGOS” në pyetësorët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022, është afërsisht 85%.

Megjithëse përqindja në total është domethënëse, pjesëmarrja nuk është e shpërndarë njëtrajtësisht sipas programeve, prandaj mbetet për t’u bërë më shumë në këtë drejtim.

Konkretisht NJSBC propozon:

- Bashkëpunim më i ngushtë me njësitë bazë për ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e procesit të vlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Gjithashtu bashkëpunimi me njësitë bazë për nxitjen e aksesimit nga ana e studentëve të platformave zyrtare të vendosura nga kolegji për komunikim zyrtar midis strukturave;

- Rishikimin e instrumenteve të përdorur për matjen e cilësisë së mësimdhënies nga studentët në aspektin e thjeshtimit të gjuhës së përdorur për formulimin e pyetjeve të pyetësorëve nëse gjykohet e nevojshme, ose trajnimin e studentëve për interpretimin e përmbajtjes së instrumenteve të përdorur me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë.

Bazuar në Nenin 27 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, komunikimi i rezultateve të vlerësimit është kryer nëpërmjet raportit të monitorimit të hartuar nga NJSBC që u është komunikuar Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe drejtuesve të njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Këto raporte përdoren për përmirësimin e performancës së personelit akademik sipas Nenit 28 të Rregullores. Gjithashtu, rezultatet e vlerësimit i janë dërguar elektronikisht stafit akademik në mënyrë individuale.



Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies në Semestrin e II-rë të vitit akademik 2021-2022 dhe për vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj, si dhe të objektivave të parashikuara për kryerjen e veprimtarive monitoruese, vlerësuese e përmirësuese si një mënyrë e garantimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”, ka organizuar e monitoruar procesin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët, për lëndët e semestrit të dytë të vitit akademik 2021-2022 si dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë.

Pasi u diskutua mbi mundësinë e përmirësimit të instrumentit të përdorur për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies (diskutim i gjeneruar nga problematikat e hasura gjatë semestrit të parë me vështirësinë e të kuptuarit të disa pyetjeve të pyetësorit kryesisht nga studentët e viteve të para), NJSBC nëpërmjet anëtarëve të saj përfaqësues të njësive kryesore të Kolegjit Universitar “LOGOS” shtroi për diskutim dhe ftoi drejtuesit e njësive për sugjerime të mundshme në përmirësim të instrumentit të përdorur. Pas diskutimeve, u vendos që të përdorej i njëjti instrument i miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe u sugjerua mundësia e trajnimit të studentëve për përmbajtjen e formularit vlerësues për cilësinë e mësimdhënies.

Procesi inicioi në javën e XIII-të të semestrit të dytë me përgatitjen e formularëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të veprimtarisë së departamenteve të Kolegjit Universitar “LOGOS” të cilat u postuan në klasat përkatëse në platformën Microsoft Teams. Këtë semestër vlerësimi u krye për çdo staf akademik efektiv e të ftuar në çdo lëndë në të cilat ata angazhohen.

U monitorua vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në këtë proces dhe u ndërmorën disa masa nga ana e NJSBC-së për të siguruar një pjesëmarrje sa më të lartë të studentëve nga na sasiore dhe cilësore për një vlerësim sa më real.

Në përgjigje të përmirësimit të problematikave të evidentuara në semestrin e parë, NJSBC u kujdes të informonte studentët mbi strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe veprimtarinë e tyre, për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në plotësimin e pyetësorëve si një mundësi për të dëgjuar zërin e tyre me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies e mësimxënies në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Studentët u ftuan të jenë sa më të sqertë, kritik dhe sigurisht objektiv në plotësimin e pyetjeve të pyetësorit duke theksuar se anonimat i çdo studenti është kusht themelor për mbarëvajtjen e procesit dhe u informuan për mënyrën e procedimit me procesin e marrjes së informacionit e përpunimit të tij në përmbushje të plotë të këtij kushti. Gjithashtu studentëve i’u dërguan edhe udhëzime për mënyrën e plotësimit të formularëve.

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit sipas secilit grup mësimor për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies ishte:

Për Fakultetin Ekonomik:

Bachelor në Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizëm
Viti i parë – Plotësimet e formularëve: 7 plotësime për 2 pedagogë, 6 për 4 pedagogë, 5 për 2 pedagogë dhe 4 për 1 pedagog (në total efektivë 21 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 29%.</i>
Viti i dytë – Plotësimet e formularëve: 9 për 3 pedagogë; 8 për 4 pedagogë dhe 7 për 2 pedagogë (në total të regjistruar 18 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 45%.</i>
Viti i tretë:
Bachelor në Financë-Kontabilitet – Plotësimet e formularëve: 8 për 3 pedagogë (në total të regjistruar 12 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 67%.</i>
Bachelor në Menaxhim Turizëm – Plotësimet e formularëve: 3 për 3 pedagogë (në total të regjistruar 4 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 75%.</i>

Bachelor në Menaxhim Biznes – Plotësimet e formularëve: 10 për 2 pedagogë, 11 për 1 pedagog dhe 9 për 1 pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 63%.</i> <i>Shënim:</i> Një nga lëndët ishte e përbashkët për të treja programet e studimit dhe për atë pedagog ka 20 plotësime.
Master Profesional në Financë-Kontabilitet
Plotësimet e formularëve: 9 për 3 pedagogë, 8 për 1 pedagog dhe 7 për 1 pedagog (në total të regjistruar 13 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 65%.</i>
Programi Diplomë profesionale në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
Viti I – Plotësimet e formularëve: 6 plotësime për 5 pedagogë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 86%.</i>
Viti II – Plotësimet e formularëve: 1 plotësim për 2 pedagogë, 2 plotësime për 2 pedagogë, 1 plotësim për 1 pedagog (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 50%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara:

Bachelor në Informatikë e Zbatuar
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 8 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 10. <i>Pjesëmarrja afërsisht 62%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 9 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 10. <i>Pjesëmarrja afërsisht 66%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 3 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 8 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 9. <i>Pjesëmarrja afërsisht 64%.</i>
Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore

Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 8. <i>Pjesëmarrja afërsisht 20%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 12 për disa formularë dhe për disa pedagogë numri i vlerësimeve është 13. <i>Pjesëmarrja afërsisht 46%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 10 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët është 3. <i>Pjesëmarrja afërsisht 14%.</i>
Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
U përgatitën 3 formularë për 3 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për 3 pedagogë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 14%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor:

Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor
Viti I - u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 7 formularët janë plotësuar nga 3 studentë (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja 100%.</i>
Viti II - u përgatitën 8 formularë për 8 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 3 për 1 pedagog, 4 për 2 pedagogë dhe 5 për 5 pedagogë (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 83%.</i>
Viti III - u përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 4 formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 67%.</i>
Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 6 formularë kishte 4 vlerësime, për 1 formular tjetër kishte 3 vlerësime (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 67%.</i>
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 6 formularë kishte nga 1 vlerësim (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i>

Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencat Religjioze
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 6 formularët kishte vetëm nga 1 vlerësim (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për të 8-të formularët kishte nga 4 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja 80%.</i>
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 4 pedagogë dhe për 4 formularë kishte nga 5 vlerësime (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 84%.</i>
Master Shkencor në Turizëm Religjioz
U përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 5 formularë kishte 5 vlerësime, për 1 formular kishte nga 1 vlerësim, për 1 formular kishte 3 vlerësime, (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 78%.</i>

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit të veprimtarisë së departamenteve ishte:

Departamenti	Formularë të plotësuar	% e pjesëmarrjes
Departamenti Financë Kontabilitet	26 formularë të plotësuar / 45 studentë gjithsej	afërsisht 58%
Departamenti i Menaxhimit	24 formularë të plotësuar / 45 studentë gjithsej	afërsisht 53%
Departamenti i Agrobiznesit	8 formularë të plotësuar / 10 studentë gjithsej	80%
Departamenti i Shkencave Mjekësore	25 formularë të plotësuar / 96 studentë gjithsej	afërsisht 26%
Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës	29 formularë të plotësuar / 46 studentë gjithsej	afërsisht 63%
Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek	3 formularë të plotësuar / 8 studentë gjithsej	afërsisht 38%

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë	12 formularë të plotësuar / 14 studentë gjithsej	afërsisht 86%
Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës	14 formularë të plotësuar / 22 studentë gjithsej	afërsisht 67%

Rezultatet e vlerësimit të kryer për çdo departament:

Departamenti Financë-Kontabilitet

Vlerësimi i Departamentit Financë-Kontabilitet ishte përgjithësisht pozitiv dhe studentët kanë vlerësuar punën e bërë gjatë këtij viti akademik nga anëtarët e departamentit. NJSBC vlerëson se departamenti duhet të përmirësojë punën e tij në lidhje me mbështetjen e studentëve për praktikën profesionale dhe përmirësimin e saj, të marrë në konsideratë mendimin e studentëve për përmirësimin e mësimdhënies dhe programit të studimit si dhe të tërheqë mendimin e tyre për çështje të literaturës që përdoret në lëndë të ndryshme.

Në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik, gjatë semestrit të dytë akademik është vënë re një interes më i lartë në plotësim nga studentët e programit Master Profesional dhe një rënie e lehtë në përqindjen e plotësimit nga studentët e vitit të tretë. Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit. Studentët kanë shprehur konsideratë veçanërisht për stafin akademik efektiv. Problematikë, edhe në krahasim me semestrin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në procesin e vlerësimit.

Departamenti i Menaxhimit

Në vlerësimin e Departamentit të Menaxhimit vërehet që studentët janë kryesisht të kënaqur me punën e tij, megjithatë NJSBC, bazuar në të dhënat e anketimit sugjeron që departamenti duhet të jetë më aktiv në lidhje me marrjen në konsideratë të mendimit të

studentëve mbi përmirësimin e praktikës si edhe për përzgjedhjen e literaturës të përdorur. Gjithashtu departamenti duhet të përmirësojë punën e tij në lidhje me vënien në dispozicion të studentëve të planit mësimor të programit të studimit si dhe të mbështesë me më shumë veprimtari kërkimin shkencor të studentëve.

Në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik, gjatë semestrit të dytë akademik është vënë re një interes më i lartë në plotësim nga studentët e vitit të tretë të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi dhe një rënie e lehtë në përqindjen e plotësimit nga studentët e vitit të tretë të programit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Problematikë, edhe në krahasim me semestrin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në procesin e vlerësimit. Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik, veçanërisht të atij efektiv. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Agrobiznesit

Vlerësimi i Departamentit të Agrobiznesit ishte kryesisht pozitiv dhe pjesëmarrja në anketimin për vlerësimin e këtij departamenti ishte tepër e kënaqshme. NJSBC vlerëson se departamenti duhet të përmirësojë punën e tij në lidhje me mbështetjen e studentëve për praktikën profesionale dhe përmirësimin e saj dhe gjithashtu të tërheqë mendimin e studentëve për çështje të literaturës që përdoret në lëndë të ndryshme.

Në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik, edhe gjatë semestrit të dytë akademik është vënë re një interes i lartë në plotësimin e formularëve. Në rastin e vlerësimit të një stafi akademik efektiv në dy lëndë të ndryshme, është evidentuar një vlerësim i dobët nën mesatare, vlerësim i cili kërkon vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës

Vlerësimi i Departamentit të Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës ishte përgjithësisht pozitiv dhe studentët kanë vlerësuar punën e bërë gjatë këtij viti akademik nga anëtarët e departamentit. Nga analizimi i vlerësimit të pyetësorit, NJSBC konkludon se

departamenti duhet të angazhohet më tepër në vënien në dispozicion të studentëve të planit mësimor të programit të studimit që ofron ky departament, në mbështetjen që departamenti i ofron studentëve në praktikën profesionale dhe në marrjen e mendimit të studentëve për përmirësimin e praktikës profesionale.

Në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik, angazhimi i studentëve në pjesëmarrjen në pyetësor ishte pak a shumë në të njëjtat nivele si në semestrin e parë. Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Shkencave Mjekësore

Në lidhje me Departamentin e Shkencave Mjekësore, NJSBC evidenton problematikën problematikën e theksuar në pjesëmarrjen e ulët të studentëve në procesin e vlerësimit. Nga analizimi i formularëve të plotësuar, vlerësimi i punës së departamentit ishte kryesisht pozitiv. NJSBC konkludon se departamenti duhet të angazhohet më tepër në mbështetjen që i ofron studentëve për praktikën profesionale dhe të realizojë më shumë veprimtari mbështetëse për përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor. Gjithashtu duhet të kërkojë mendimin e studentëve për përmirësimin e programit të studimit dhe të kërkojë mendimin e studentëve për çështje të literaturës që përdoret në lëndë të ndryshme.

Në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik, pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit ishte gjithashtu shumë e ulët duke shënuar zbritje të përqindjes së pjesëmarrjes në krahasim me semestrin e parë. Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët pjesëmarrës në anketim dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

Pjesëmarrja e studentëve të Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë në të dyja anketimet ishte tepër e kënaqshme. Vlerësimi i punës së departamentit ishte përgjithësisht pozitiv në të gjitha aspektet e evidentuara për vlerësim në pyetësor.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës

Përsa i përket Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës pjesëmarrja e studentëve në vlerësim ishte e kënaqshme si për vlerësimin e veprimtarisë së departamentit, ashtu edhe për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, krahasuar kjo e fundit edhe me semestrin e parë. Studentët kanë vlerësuar pozitivisht punën e departamentit. Informimi mbi programin e studimit, programin mësimor të lëndëve dhe rregullorja e studimeve, informimi mbi çështjet e mësimin, mbështetja për praktikën profesionale marrin vlerësim maksimal. Ndërkohë një vlerësim shumë të mirë kanë edhe aspekte të tjera të veprimtarisë së departamentit si: marrja e mendimit për përmirësimin e praktikës mësimore, përmirësimin e programit të studimit, përmirësimin e mësimdhënies dhe vlerësimi për tërheqjen e mendimit për përmirësimin e literaturës në lëndë të ndryshme.

Përsa i përket vlerësimit të stafit akademik nga studentët dalin në pah miratimi i metodologjisë, komunikimit dhe materialeve, të cilët përdoren në lëndët e këtij semestri. Ka disa raste të veçuara mbi metodën e mësimdhënies, por në raport me tërësinë e vlerësimit është i papërfillshëm. Në ndonjë rast të veçantë shprehen për ndryshim mbi materialin, pasi është i ngarkuar apo ndonjëherë kërkohen orë tepër për ndonjë lëndë, për shkak të interesit që paraqet. Sygjerimi për departamentin është që të shikoj këto problematika, por ndërkohë që departamenti bën rishikim të përvitshëm të programit mësimor, fokusuar tek temat dhe materialet që shoqërojnë ato.

Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek

Përsa i përket Departamentit të Gjuhës dhe Civilizimit Grek ka një rritje të pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies krahasuar me semestrin e parë, por nuk ka një pjesëmarrje të kënaqshme në plotësimin e formularit të vlerësimit të departamentit.

Nga analizimi i formularëve të plotësuar, vlerësimi i punës së departamentit ishte kryesisht pozitiv në të gjitha aspektet e evidentuara në pyetësor. Vihet re një lloj paqartësie, e cila reflektohet me përgjigjen “nuk e di”. Kjo paqartësi (në përqindje minimale) shprehet në pyetjet për praktikën mësimore, tërheqjen e mendimit për përmirësimin e saj dhe organizimi i aktiviteteve mbështetëse për përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor.

Ndërsa përsa u përket vlerësimit të pedagogëve, spikasin vlerësime të larta për përgatitjen e pedagogëve, materialin që u ofrojnë studentëve dhe komunikimin e mirë dhe të shëndetshëm që kanë ata me studentët. Nuk vërehen problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të vlerësimit të veprimtarisë akademike dhe kërkimore gjatë vitit akademik në shqyrtim (2021-2022), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) evidenton se Kolegji Universitar “LOGOS” ka shënuar përmirësime të dukshme dhe të qëndrueshme në fushën e sigurimit të cilësisë, si në aspektin e programeve të studimit, ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore.

Konkretisht, është vënë re një rritje e ndjeshme në nivelin e koordinimit akademik dhe institucional, që ka ndikuar pozitivisht në harmonizimin e proceseve mësimore me objektivat e programeve të studimit dhe në përmirësimin e performancës së përgjithshme akademike. Gjithashtu, angazhimi i stafit akademik në veprimtari kërkimore dhe në përditësimin e përmbajtjeve të lëndëve ka kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në forcimin e lidhjes midis kërkimit dhe praktikës akademike.

Këto arritje pasqyrojnë përkushtimin e vazhdueshëm të Kolegjit për të konsoliduar një kulturë të qëndrueshme të cilësisë.

Rekomandime

Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë dhe bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura gjatë vitit akademik, NJSBC rekomandon:

- -Vazhdimin e trajnimeve periodike për studentët, me fokus në mënyrën korrekte të plotësimit të formularëve të vlerësimit të performancës së pedagogëve sipas lëndëve, në mënyrë që të sigurohet një proces i unifikuar dhe objektiv vlerësimi.
- Zbatimin e vlerësimit të rregullt të pedagogëve për të gjitha lëndët që ata zhvillojnë gjatë një viti akademik, në mënyrë që rezultatet të reflektojnë performancën e plotë dhe të shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Në përfundim, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson se Kolegji Universitar “LOGOS” ka demonstruar një përparim të qëndrueshëm në ndërtimin e një sistemi funksional të sigurimit të cilësisë, që mbështet zhvillimin akademik, kërkimor dhe institucional në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Përpiloi raportin: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

KRYETARI

Entela Kostista



Anëtarët

Xhezmije Lulo



Klejda Gabeshi



Thoma Çomëni



Malisa Miftari



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDACIONI “LOGOS”
KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”**



**RAPORT VJETOR
PËR
VEPRIMTARINË E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË
TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”
PËR VITIN AKADEMIK
2022-2023**

Shtator, 2023



Pasqyra e Lëndës

HYRJE	3
PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	4
Akreditimi Periodik.....	4
Përbushja e Rekomandimeve të Vendimeve të Bordit të Akreditimit	4
Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për Akreditim	5
Veprimtaria e Vazhdueshme.....	5
Aktivitete Informuese.....	6
Aktivitete Vlerësuese	6
Informacion për vlerësimin e pyetësorëve.....	12
MENDIME E REKOMANDIME	20
Aneksë.....	
.....	24



HYRJE

Kolegji Universitar “LOGOS” ka hartuar politika, ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, Neni 103, pika 1 dhe në aktet rregullatore të brendshme, Kolegji Universitar “LOGOS” ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në nivel institucioni, veprimtaria e të cilave mbështetet në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. Si përmbushje e objektivit 2 të prioritetit strategjik 6: Sigurimi i Cilësisë, i evidentuar nga Kolegji Universitar “LOGOS” në planin e tij strategjik, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet me qëllim përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë. Ky sistem ndjek, vlerëson dhe monitoron procesin e mësimdhënies dhe koordinon e bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet për arritjen e një cilësie të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Pjesë e anëtarësisë në të dyja strukturat, është edhe përfaqësuesi i trupës studentore me një rol aktiv në proceset e cilësisë.

Veprimtaria për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” udhëhiqet nga Politika për Sigurimin e Cilësisë e hartuar në përputhje me Kodin e Cilësisë, siç udhëzon pika 5 e nenit 103 të Ligjit nr 80/2015 dhe i referohet një procesi të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi dhe përmirësimi të cilësisë së kolegjit e programeve që ai ofron duke u bazuar në kritere të brendshme e të jashtme. Menaxhimi i cilësisë, rritja e cilësisë, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i cilësisë, janë mjete nëpërmjet të cilave sigurohet cilësia në institucion. Sigurimi i cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” ka tre qëllime kryesore: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si pjesë e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, krijon, pasuron dhe mirëmban sistemin e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm dhe në bazë të rezultateve të monitorimeve të kryera, përgatit raporte të cilat u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera përdoren për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.





PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë paraqet raportin për veprimtarinë e kryer gjatë vitit akademik 2022-2023 sipas Rregullore së Sigurimit të Cilësisë (Kreu III, Neni 16, pika x).

Raporti përmban:

1. informacion të përmbledhur për veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj;
2. informacion për veprimtarinë e njësive në përmbushje të objektivave të saj vjetore bazuar në zbatim të Politikave për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Universitar "LOGOS";
3. informacion për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies (për semestrin e I-rë dhe të II-të) dhe për vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë të Kolegjit Universitar "LOGOS";
4. mendime dhe rekomandime.

Raporti vjetor i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është hartuar bazuar në veprimtarinë e saj dhe të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë, Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe njësive bazë të Kolegjit Universitar "LOGOS".

Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë (*Kreu III, Neni 16, pika 2*), në përmbushje të misionit të saj, për planifikimin, drejtimin, organizimin dhe publikimin e veprimtarisë së kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimit të Kolegjit Universitar "LOGOS" për krijimin e kulturës së cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), argumenton në mënyrë të përmbledhur realizimin e objektivave vjetore për vitin akademik 2022-2023:

Akreditimi Periodik

1. Në përmbushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/d:
 - A. NJSBC në kuadër të akreditimit periodik të programeve të ciklit të dytë:
 - Master Profesional në "Financë Kontabilitet" (akreditim periodik)
 - Master Profesional në "Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore" (akreditim periodik)

- Master i Shkencave në "Turizëm Religjioz" (akreditim për herë të parë)

ka planifikuar e menaxhuar vlerësimin e brendshëm duke suportuar GVB-të përkatëse me asistencë teknike për kryerjen e vetëvlerësimit sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë dhe duke bashkëpunuar me ASCAL për vlerësimin e jashtëm të këtyre programeve.

Përmbushja e Rekomandimeve të Vendimeve të Bordit të Akreditimit

- B. NJSBC ka monitoruar planin e veprimit të institucionit në përmbushje të rekomandimeve në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit (Nr. 58, datë 16.12.2021, "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, Kolegji Universitar "Logos") dhe ka bashkëpunuar me strukturat përkatëse për përmbushjen e këtij plani.

Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për Akreditim

- C. Sipas planit të veprimtarisë të saj, NJSBC ka planifikuar vlerësimin e brendshëm gjatë vitit akademik 2023-2024 të programeve të studimit të ciklit të dytë:
- Master i Shkencave në Përkthim Profesional (akreditim për herë të parë)
 - Bachelor në Financë-Kontabilitet (akreditim periodik)

duke asistuar në punën përgatitore të njësive bazë për procesin e vlerësimit të brendshëm dhe duke njohur strukturat e përfshira në këtë proces me modelin e ri të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bazuar në Kodin e ri të Cilësisë së Arsimit të Lartë (miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021).

Veprimtaria e Vazhdueshme

2. *Përmbushjen e përgjegjësisë të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/j*, për vlerësimin e ecurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji Universitar "LOGOS", NJSBC e ka kryer nëpërmjet bashkëpunimit përkatësisht me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe me njësitë bazë të Kolegjit Universitar "LOGOS" duke përdorur metoda e instrumente të drejtëpërdrejta e të tërthorta vlerësimi, si:
- pyetësorë të studentëve në fund të cdo semestri për cilësinë e mësimdhënies dhe veprimtarinë e departamentit
 - të dhëna nga studentë të diplomuar, aktivë në tregun e punës anëtarë të LOGOS Alumni;
 - të dhëna nga analiza e punës së departamenteve
 - mendimin e ekspertëve të jashtëm të fushës gjatë proceseve të akreditimeve të mëparshme të programeve të studimit të ofruara nga Kolegji Universitar "LOGOS".

Rezultatet e këtyre monitorimeve janë pasqyruar në raportet vjetore të njësive bazë të Kolegjit Universitar "LOGOS".



Aktivitete Informuese

3. Bazuar në Nenin 16, pika 3/l të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, NJSBC ka organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët e Kolegjit Universitar “LOGOS” për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet:
 - Zhvillimit të seancave të informimit të studentëve mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, treguesit e përdorur e mënyra e interpretimit të tyre;
 - Trajnimit të stafit të ri akademik të përfshirë në strukturat e sigurimit të cilësisë për përfitimin e përvojës në këtë drejtim me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë gjithmonë e më të gjerë në institucion.

Aktivitete Vlerësuese

4. Në përmbushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/h & i, NJSBC në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies nga studentët dhe në fund të vitit akademik, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e veprimtarisë së njëjësive bazë dhe të shërbimeve për studentët duke përdorur paketën e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë të miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” bazuar në manualin e Cilësisë (sipas Kreut IV/Procedura të sigurimit të cilësisë, Neni 24/Inicimi i vlerësimit).

Në zbatim të Nenit 27 të Rregullores/Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit, NJSBC ka mbikëqyrur procesin për komunikimin dhe publikimin e vlerësimit, me qëllim garantimin se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë të jetë i përshtatshëm për qëllimin që ka, i arritshëm e i besueshëm.

Për këtë qëllim, janë hartuar raporte semestrale adresuar Rektorit të Kolegjit Universitar “Logos” dhe gjithashtu Kryetarit të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe drejtuesve të njëjësive bazë në të cilat pasqyrohet qartë metodologjia e vlerësimit, matësit e përdorur, rezultatet e pritshme e interpretimi i tyre dhe sigurisht rezultatet e vlerësimit.

Në këto raporte evidentohen krahasimet e rezultateve semestrale për cilësinë e mësimdhënies ose krahasim në bazë vjetore për vlerësimin e veprimtarisë së departamenteve; evidentohen sugjerimet objektive të studentëve; adresohen mangësitë e evidentuara dhe sugjerohen masat e nevojshme që duhet të merren në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Këto raporte janë përdorur për përmirësimin e performancës së personelit akademik sipas Nenit 28/ Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit.

Reflektimi mbi sugjerimet e dhëna nga këto raporte, janë shprehur përmes:

- trajnimeve të stafit akademik nga ekspertë të huaj e profesorë të Universiteteve partnere për metodat e mesimdhënies dhe organizimin e simpoziumeve shkencore me fokuse edukimin;
- mbështetjes së stafit për rritjen e formimit të tyre akademik e shkencor;
- rritjes së numrit të mobiliteteve të stafit akademik në universitetet partnere në kuadër të programit Erasmus+, etj.

Informacion për vlerësimin e pyetësorëve

Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mesimdhënies në Semestrin e I-rë të vitit akademik 2022-2023

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj, si dhe të objektivave të parashikuara për kryerjen e veprimtarive monitoruese, vlerësuese e përmirësuese si një mënyrë e garantimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” bazuar në Kreun III, Nenin 16 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, ka organizuar e monitoruar procesin e vlerësimit të cilësisë së mesimdhënies nga studentët, për lëndët e semestrit të parë të vitit akademik 2022-2023.

Ky proces u iniciua me shpërndarjen e formularëve, pjesë e paketës së intrumenteve të miratuar nga Senati Akademik i KU “LOGOS” bazuar në manualin e Cilësisë (sipas Kreut IV/Procedura të sigurimit të cilësisë, Neni 24/Inicimi i vlerësimit).

Pasi u përgatitën formularët e vlerësimit për çdo pedagog, efektiv e të ftuar, të angazhuar në programet e ofruara nga KU “LOGOS” (çdo pedagog është vlerësuar në të gjitha lëndët që mbulon), të cilat u postuan në klasat përkatëse të administruar nga IT në Microsoft Teams (sipas programeve e viteve të studimit).

Ky proces u realizua në nisjen e javës së XIV dhe në përfundim të javës së XV të semestrit të parë.

U monitorua vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në këtë proces dhe u ndërmorën disa masa nga ana e NJSBC-së për të siguruar një pjesëmarrje sa më të lartë të studentëve. Për këtë qëllim, është kryer një komunikim i drejtpërdrejtë me studentët për të evidentuar problematika të mundshme si p.sh. mosaksesimi i llogarive në Microsoft Teams për plotësimin e formularëve, apo moskuptimi i pyetjeve të përfshira në formular për një vlerësim sa më objektiv. Si pasojë, u reshetuan nga IT një numër i konsiderueshëm i llogarive të studentëve të evidentuar me këtë problematikë.

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit sipas secilit grup mësimor ishte:




Për Fakultetin Ekonomik:

Bachelor në Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizëm
Viti i parë – u përgatitën 11 formularë për 11 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 6 për pedagog (në total të regjistruar 14 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 43%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën 8 formularë për 8 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 7 për pedagog (në total të regjistruar 22 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 32%.</i>
Viti i tretë:
Bachelor në Financë-Kontabilitet – u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 4 për pedagog (në total të regjistruar 10 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 40%.</i>
Bachelor në Menaxhim Turizëm – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 2 për pedagog (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 100%.</i>
Bachelor në Menaxhim Biznes – u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për pedagog (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 14%.</i>
Master Profesional në Financë-Kontabilitet
U përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 12 për pedagog (në total të regjistruar 14 studentë (aktivë)). <i>Pjesëmarrja afërsisht 86%.</i>
Programi Diplomë profesionale në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
Viti I – u përgatitën 9 formularë për 9 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 1 për pedagog (në total të regjistruar 1 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 100%.</i>
Viti II – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 29%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara:

Bachelor në Informatikë e Zbatuar
--



Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 44%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 11 për pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 69%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 6 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 10 për pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 63%.</i>
Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 10 për pedagog (në total të regjistruar 24 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 42%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 9 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 7 për pedagog (në total të regjistruar 39 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 18%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan ishte mesatarisht 3 për pedagog (në total të regjistruar 28 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 11%.</i>
Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
U përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 8 për pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 50%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor:

Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor
Viti I - u përgatitën 9 formularë për 9 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 9 formularët janë plotësuar nga 7 studentë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja 100%.</i>
Viti II - u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 2 për pedagog (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 40%.</i>
Viti III - u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe 6 formularët janë plotësuar nga 4 studentë (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja 66%.</i>
Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek

Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për formularët kishte 2 vlerësime (në total të regjistruar 4 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i>
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për formularët kishte 1 vlerësim (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja 16.5%.</i> Në vitin e tretë studenti i vetëm, i cili ka plotësuar formularët, nuk i ka plotësuar të gjithë.
Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencat Religjioze
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për 8 formularët kishte 3 vlerësime (në total të regjistruar 4 studentë). <i>Pjesëmarrja 75%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për të 8-të formularët kishte nga 1 vlerësim (në total të regjistruar 1 studentë). <i>Pjesëmarrja 100%.</i>
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për formularët kishte nga 5 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 100%.</i>
Master Shkencor në Turizëm Religjioz
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 7 formularët kishte 4 vlerësime (në total të regjistruar 4 studentë). <i>Pjesëmarrja 100%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për të 7-të formularët kishte nga 4 vlerësime (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja 44%.</i>
Bachelor në Punë Sociale
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 9 pedagogë dhe për 9 formularët kishte 4 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja 80%.</i>
Master i Shkencave në Përkthim Profesional
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 6 formularët kishte 1 vlerësim (në total të regjistruar 3 studentë). <i>Pjesëmarrja 33%.</i>

Nga ndjekja e procesit të vlerësimit të pedagogëve, u vunë re disa **problematika**:

- Angazhimi i pamjaftueshëm të studentëve në plotësimin e formularëve;
- Vështirësi në perceptimin e pyetjeve të pyetësorit.

Për problematikat e evidentuara, NJSBC-ja në bashkëpunim me Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe me njësitë bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”, ka ndërmarrë masa të ndryshme duke komunikuar me studentët verbalisht në auditore apo në mjete komunikimi të ndryshme (grupe të organizuara në chat’s up apo Microsoft Teams) për zgjidhjen e vështirësive teknike të shfaqura tek studentët në lidhje me aksesimin e formularëve, për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për rëndësinë që mbart procesi; si për të kuptuar drejtë pyetjet e pyetësorëve për

një vlerësim sa më objektiv, ashtu edhe për të arritur një pjesëmarrje sa më përfaqësuese të studentëve në procesin e vlerësimit.

Përqindja e pjesëmarrjes totale të studentëve të Kolegji Universitar "LOGOS" në pyetësorët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për semestrin e parë të vitit akademik 2022-2023, është afërsisht 57%.

Megjithëse përqindja në total është domethënëse, pjesëmarrja nuk është e shpërndarë njëtrajtësisht sipas programeve, prandaj mbetet për t'u bërë më shumë në këtë drejtim.

Konkretisht NJSBC propozon:

- Rishikimin e formularëve me qëllim thjeshtim (nëse është e mundur) të gjuhës së përdorur në formulimin e pyetjeve;
- Një trajnim të shkurtër të përgjithshëm ose të paktën të përfaqësuesve të studentëve në strukturat e ngitura (këshill studentor, senator etj);
- Bashkëpunim më i ngushtë me njësitë bazë me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e këtij procesi në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies dhe për rëndësinë që ka aksesimin i platformave zyrtare të vendosura nga KU "LOGOS" për komunikim zyrtar midis strukturave.

Sipas Nenit 27/Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit, procesi për komunikimin dhe publikimin e monitorimit, vlerësimit, është mbikqyrur nga NJSBC-ja me qëllim garantimin se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë të jetë i përshtatshëm për qëllimin që ka, i arritshëm e i besueshëm.

Komunikimi i rezultateve të vlerësimit është kryer nëpërmjet raporteve të monitorimit që u janë komunikuar organeve strukturave dhe autoriteteve përkatëse të KU LOGOS. Këto raporte përdoren për përmirësimin e performancës së personelit akademik sipas Nenit 28/Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit.

Gjithashtu, rezultatet e vlerësimit do t'i dërgohen elektronikisht, Rektorit të KU "Logos", Përgjegjësve të Departamenteve si dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.



**Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies në
Semestrin e II-rë të vitit akademik 2022-2023 dhe për vlerësimin e veprimtarisë së njësive
bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj, si dhe të objektivave të parashikuara për kryerjen e veprimtarive monitoruese, vlerësuese e përmirësuese si një mënyrë e garantimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”, ka organizuar e monitoruar procesin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët, për lëndët e semestrit të dytë të vitit akademik 2022-2023 si dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë.

Pasi u diskutua mbi mundësinë e përmirësimit të instrumentit të përdorur për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies (diskutim i gjeneruar nga problematikat e hasura gjatë vitit të kaluar me vështirësinë e të kuptuarit të disa pyetjeve të pyetësorit kryesisht nga studentët e viteve të para), NJSBC nëpërmjet anëtarëve të saj përfaqësues të njësive kryesore të Kolegjit Universitar “LOGOS” shtroi për diskutim dhe ftoi drejtuesit e njësive për sugjerime të mundshme në përmirësim të instrumentit të përdorur. Pas diskutimeve, u vendos që të përdorej i njëjti instrument i miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe u sugjerua mundësia e trajnimit të studentëve për përmbajtjen e formularit vlerësues për cilësinë e mësimdhënies.

Procesi inicioi në javën e XIII-të të semestrit të dytë me përgatitjen e formularëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të veprimtarisë së departamenteve të Kolegjit Universitar “LOGOS” të cilat u postuan në klasat përkatëse në platformën Microsoft Teams. Vlerësimi u krye për çdo staf akademik efektiv e të ftuar në çdo lëndë në të cilat ata angazhohen.

U monitorua vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në këtë proces dhe u ndërmorën disa masa nga ana e NJSBC-së për të siguruar një pjesëmarrje sa më të lartë të studentëve nga na sasiore dhe cilësore për një vlerësim sa më real.

Në përgjigje të përmirësimit të problematikave të evidentuara në semestrin e parë, NJSBC u kujdes të informonte studentët mbi strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe veprimtarinë e tyre, për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në plotësimin e pyetësorëve si një mundësi për të dëgjuar zërin e tyre me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies e mësimxënies në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Studentët u ftuan të jenë sa më të sinqertë, kritik dhe sigurisht objektiv në plotësimin e pyetjeve të pyetësorit duke theksuar se anonimati i çdo studenti është kusht themelor për mbarëvajtjen e procesit dhe u informuan për mënyrën e procedimit me procesin e marrjes së informacionit e përpunimit të tij në përmbushje të plotë të këtij kushti.


- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit sipas secilit grup mësimor për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies ishte:

Për Fakultetin Ekonomik:

Bachelor në Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizëm
Viti i parë – u përgatitën 8 formularë për 8 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 3 për pedagog (në total të regjistruar 14 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 21%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 22 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 18%.</i>
Viti i tretë: Bachelor në Financë-Kontabilitet – u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 5 për pedagog (në total të regjistruar 10 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i> Bachelor në Menaxhim Turizëm – u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për pedagog (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i> Bachelor në Menaxhim Biznes – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për pedagog (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 14%.</i>
Master Profesional në Financë-Kontabilitet
U përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 10 për pedagog (në total të regjistruar 14 studentë (aktivë)). <i>Pjesëmarrja afërsisht 71%.</i>
Programi Diplomë profesionale në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
Viti I – u përgatitën 3 formularë për 3 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 0 për pedagog (në total të regjistruar 1 studentë). <i>Pjesëmarrja 0%.</i>
Viti II – u përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe formularët janë plotësuar nga 0 studentë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja 0%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara:

Bachelor në Informatikë e Zbatuar
--



Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 2 për pedagog (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 22%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 25%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 3 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 5 për pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 31%.</i>
Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 5 për pedagog (në total të regjistruar 24 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 21%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 39 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 10%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 9 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan ishte mesatarisht 9 për pedagog (në total të regjistruar 28 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 32%.</i>
Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
U përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 0 (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja 0%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor:

Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor
Viti I - formularët janë plotësuar nga 3 studentë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 42%.</i>
Viti II - formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 40%.</i>
Viti III - formularët janë plotësuar nga 4 studentë (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 66%.</i>
Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek

Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 4 studentë).
Pjesëmarrja 50%.

Viti i tretë – formularët janë plotësuar nga 1 student (në total të regjistruar 6 studentë).
Pjesëmarrja afërsisht 16%.

Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencat Religjioze

Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 4 studentë).
Pjesëmarrja 50%.

Viti i dytë – formularët janë plotësuar nga 0 studentë (në total të regjistruar 1 studentë).
Pjesëmarrja 0%.

Viti i tretë – formularët janë plotësuar nga 4 studentë (në total të regjistruar 5 studentë).
Pjesëmarrja 80%.

Master Shkencor në Turizëm Religjioz

Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 4 studentë).
Pjesëmarrja 50%.

Viti i dytë – formularët janë plotësuar nga 0 studentë (në total të regjistruar 7 studentë).
Pjesëmarrja 0%. Për semestrin e dytë të vitit të dytë studentët janë marrë me praktikën dhe punimin e tezave të masterit shkencor.

Bachelor në Punë Sociale

Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 4 studentë (në total të regjistruar 5 studentë).
Pjesëmarrja 80%.

Master i Shkencave në Përkthim Profesional

Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 1 student (në total të regjistruar 3 studentë).
Pjesëmarrja afërsisht 33%.

➤ Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit të veprimtarisë së departamenteve ishte:

Departamenti	Formularë të plotësuar	% e pjesëmarrjes
Departamenti Financë Kontabilitet	14 formularë të plotësuar / 42 studentë gjithsej	afërsisht 33%
Departamenti i Menaxhimit	8 formularë të plotësuar / 30 studentë gjithsej	afërsisht 27%

Departamenti i Agrobiznesit	0 formularë të plotësuar / 8 studentë gjithsej	0%
Departamenti i Shkencave Mjekësore	14 formularë të plotësuar / 107 studentë gjithsej	afërsisht 13%
Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës	9 formularë të plotësuar / 41 studentë gjithsej	afërsisht 22%
Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë	5 formularë të plotësuar / 13 studentë gjithsej	afërsisht 38%
Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë	7 formularë të plotësuar / 23 studentë gjithsej	afërsisht 30%
Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës	6 formularë të plotësuar / 21 studentë gjithsej	afërsisht 29%

Rezultatet e vlerësimit të kryer për çdo departament:


Ajo që u konstatua nga ky proces është se ekziston një pjesëmarrje e ulët e studentëve në disa programe, pavarësisht masave të marra nga ana jonë pas semestrit të parë.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika madhore të cilat kërkojnë ndërhyrje nga secili fakultet.

Departamenti Financë-Kontabilitet

Vlerësimi i Departamentit Financë-Kontabilitet ishte mjaft pozitiv dhe studentët kanë vlerësuar punën e bërë gjatë këtij viti akademik nga anëtarët e departamentit. Vlen të theksohet se vlerësimi i punës së departamentit ishte i lartë në të gjitha aspektet e evidentuara për vlerësim në pyetësor. NJSBC vlerëson se departamenti duhet të përmirësojë punën e tij në lidhje me mbështetjen e studentëve për praktikën profesionale dhe përmirësimin e saj si dhe të tërheqë mendimin e tyre për çështje të literaturës që përdoret në lëndë të ndryshme.

Zhvillimi i procesit mësimor u vlerësua pozitivisht nga studentët dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit. Studentët kanë shprehur konsideratë për stafin akademik efektiv dhe atë me kontratë. Problematikë, edhe në krahasim me semestrin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në procesin e vlerësimit. Nga të gjithë formularët e analizuar, vetëm një pedagog ka pasur vlerësim lehtësisht më të ulët se koeficienti 4.



Departamenti i Menaxhimit

Për Departamentin e Menaxhimit studentët kanë dhënë vlerësim pozitiv. Problematikë, edhe në krahasim me semestrin e kaluar, mbetet pjesëmarrja e ulët e studentëve të programit Menaxhim Biznesi. Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik, efektiv dhe me kontratë. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit. Kërkohet ndjekja më nga afër e aktivizimit të studentëve në procesin e vlerësimit me qëllim pasjen e një pjesëmarrjeje më të lartë dhe rezultateve më afër realitetit.

Departamenti i Agrobiznesit

Nuk është arritur të kryhet sipas parashikimeve vlerësimi për Departamentin e Agrobiznesit. NJSBC vlerëson se departamenti duhet të përmirësojë punën në lidhje me nxitjen e studentëve në plotësimin e pyetësorëve, pasi në të dy semestrat vihet re në pjesëmarrje e ulët.

Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës

Vlerësimi i Departamentit të Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës ishte pozitiv dhe studentët kanë vlerësuar punën e bërë gjatë këtij viti akademik nga stafi pedagogjik. Koeficienti i vlerësimit për të gjitha lëndët përfshirë programin, metodikën e mësimdhënies dhe punën praktike është mbi 4.5 nga 5. Nga analizimi i vlerësimit të pyetësorit, NJSBC sugjeron të punohet më tepër në drejtim të pjesëmarrjes së studentëve në procesin e vlerësimit me qëllim që t'i shërbejë më shumë rritjes së cilësisë së punës së kësaj njësie.

Në konsideratë të sugjerimeve dhe vërejtjeve të studentëve të programit Informatikë e Zbatuar dhe statistikë në semestrin e parë, në vazhdim janë ndërmarrë hapa konkretë nga departamenti për përditësimin e programeve, i cili ka përpiluar raportin mbi ndryshimet në planin mësimor për vitin akademik 2023-2024 të programit Bachelor në Informatikë e Zbatuar (*Aneksi I*). Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës ka propozuar ndryshime për përmbajtjet e veprimtarive dhe të emërtimeve, të shpërndarjes së lëndëve si dhe përditësimet në literaturë për planin mësimor për vitin akademik 2023-2024. NJSBC vlerëson se ndryshimet kanë marrë në konsideratë VKM nr. 41., datë 24.1.2018 duke respektuar masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS. Gjithashtu ndryshimet janë kryer duke marrë në konsideratë edhe disa nga sugjerimet e grupit të vlerësimit të jashtëm të reflektuara në Draft-Raportin për programin Bachelor Informatikë e Zbatuar, në dt. 03.04.2023.

Programi i studimit Bachelor në Informatikë e Zbatuar është në një proces përmirësimi për të përmbushur e respektuar standardet e përcaktuara si dhe për të kontribuar për Institucionin tonë në mënyrë që të reflektohet më së miri ndërtimi dhe promovimi i eksperiencës, dijeve dhe vlerave profesionale e njerëzore.

Departamenti i Shkencave Mjekësore

Në lidhje me Departamentin e Shkencave Mjekësore, NJSBC evidenton pjesëmarrjen e ulët të studentëve në procesin e vlerësimit, sidomos programi ‘Master Profesional në Teknikë e Lartë në laboratorë Mjekësorë’. Nga analizimi i formularëve të plotësuar, vlerësimi i punës së departamentit ishte mjaft pozitiv, me një koeficient mbi 4.7 nga 5 për të gjitha lëndët. NJSBC sugjeron të punohet më tepër në drejtim të ndërgjegjësimit të studentëve për rëndësinë e procesit të vlerësimit në shërbim të tyre. Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët pjesëmarrës në anketim dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

Vlerësimi i punës së Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë ishte përgjithësisht pozitiv në të gjitha aspektet e evidentuara për vlerësim në pyetësor. Nga analiza e bërë vërehet një pjesëmarrje e ulët e studentëve në procesin e vlerësimit. Janë bërë përpjekje për të trajnuar dhe theksuar rëndësinë e procesit dhe ruajtjen e anonimatit të tyre gjatë këtij procesi.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës

Për Departamentin e Theologjisë dhe Kulturës studentët kanë vlerësuar pozitivisht punën e tij.

Në fund të procesit të plotësimit të formularëve vërehet një pjesëmarrje e ulët e studentëve në këtë proces. Ajo që vërehet tek formularët e plotësuar është se shumica e studentëve kanë komentuar pozitivisht për secilin pedagog. Nga një student i vitit të parë, programi Bachelor, “Theologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”, është sugjeruar që pedagogu të jetë më i qartë në shpjegim dhe objektiv në vlerësim. Gjithashtu, një student i vitit të parë, në programin Master shkencor në “Turizëm Religjioz kërkon ndaj një pedagogu se duhet të vendosë në dispozicion të studentëve një literaturë më e plotë në gjuhën shqipe.

Megjithatë duhet theksuar se studentët tek ky proces kanë vlerësuar pozitivisht mësimdhënien e pedagogëve të tyre.



Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë

Edhe në këtë departament vërehet një pjesëmarrje jo e plotë në plotësimin e formularëve. NJSBC sugjeron të punohet më tepër në drejtim të ndërgjegjësimit të studentëve për rëndësinë e procesit të vlerësimit në shërbim të tyre.

Nga analizimi i formularëve të plotësuar, vlerësimi i punës së departamentit ishte kryesisht pozitiv në të gjitha aspektet e evidentuara në pyetësor. Ndërsa përsa u përket vlerësimit të pedagogëve, spikasin vlerësime pozitive për përgatitjen e pedagogëve, materialin që u ofrojnë studentëve dhe komunikimin e mirë dhe të shëndetshëm që kanë ata me studentët. Nuk vërehen problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.



MENDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të analizës së veprimtarisë akademike, kërkimore dhe institucionale gjatë vitit akademik 2022–2023, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) konstaton se Kolegji Universitar “LOGOS” ka realizuar një progres të qëndrueshëm në drejtim të përmirësimit të standardeve të cilësisë dhe të përmbushjes së objektivave strategjike institucionale.

Gjatë periudhës raportuese, janë vërejtur përmirësime të dukshme në cilësinë dhe relevancën e programeve të studimit, të cilat janë orientuar gjithnjë e më tepër drejt nevojave të tregut të punës dhe kërkesave të zhvillimit bashkëkohor, integrimi i metodave aktive të mësimdhënies kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve dhe në përmirësimin e cilësisë së të nxënit.

Njësia vlerëson gjithashtu angazhimin e shtuar të stafit akademik në veprimtarinë kërkimore-shkencore, si dhe në aplikimin e metodikave bashkëkohore që forcojnë lidhjen midis kërkimit dhe mësimdhënies. Ky zhvillim ka kontribuar në rritjen e profilit akademik të institucionit dhe në forcimin e kulturës së cilësisë në nivel organizativ.

Gjithashtu, është vënë re një përfshirje më aktive e studentëve në aktivitete praktike dhe veprimtari akademike, çka dëshmon rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi rëndësinë e mendimit kritik, punës kërkimore dhe zhvillimit profesional.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, NJSBC vlerëson se Kolegji Universitar “LOGOS” ka demonstruar një qasje të qëndrueshme dhe të përkushtuar ndaj sigurimit të cilësisë, duke ruajtur standarde të larta në mësimdhënie, kërkim dhe menaxhim institucional.

Rekomandime:

Në bazë të gjetjeve të raportit dhe në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë rekomandon:

- -Vijimin e praktikave të mira në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, me theks të veçantë në përafrimin e tyre me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe zhvillimeve teknologjike.

-Vazhdimin e monitorimit të brendshëm sistematik të performancës akademike dhe kërkimore, nëpërmjet përdorimit të indikatorëve matës dhe analizave krahasuese ndër vite.

Në përfundim, NJSBC vlerëson se rezultatet e arritura gjatë vitit akademik 2022–2023 përbëjnë një bazë solide për konsolidimin e mëtejshëm të cilësisë dhe për realizimin e objektivave strategjike të Kolegjit Universitar “LOGOS” në drejtim të ekselencës akademike dhe zhvillimit të qëndrueshëm institucional.

Përpiloi raportin: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Prof. Assoc. Dr. Tefta ROTA
Kryetare



Dr. Thoma SHKIRA
Anëtar



PhD.Cand.Klejda GABESHI
Anëtar



PËRFAQËSUESI I TRUPËS STUDENTORE
Denisa Palushi
Anëtar





Aneks I - Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës


Tiranë, më 01.09.2023

Raport mbi ndryshimet në planin mësimor për vitin akademik 2023-2024 të programit Bachelor në Informatikë e Zbatuar.

Nisur nga popullariteti i teknologjisë dhe koha digjitale në të cilën jetojmë, fusha është prioritare dhe kërkesa për këto profile është gjithmonë në rritje. Prandaj, të ndërgjegjshëm për kërkesat e kohës, Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës ka propozuar ndryshime për përmbajtjet e veprimtarive dhe të emërtimeve, të shpërndarjes së lëndëve si dhe përditësimet në literaturë për planin mësimor për vitin akademik 2023-2024.

Ndryshimet kanë marrë në konsideratë VKM nr. 41., datë 24.1.2018 duke respektuar masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS. Gjithashtu ndryshimet janë kryer duke marrë në konsideratë edhe disa nga sugjerimet e grupit të vlerësimit të jashtëm të reflektuara në Draft-Raportin për programin Bachelor Informatikë e Zbatuar, në dt. 03.04.2023. Si rrjedhojë, Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve, të shpërndarjes së lëndëve, propozoi këto ndryshime:

- Lënda Njohuri Informatike dhe aplikacione bazë e përbërë nga tre module: Hyrje në Informatikë, Përpunim teksti dhe Llogaritje të kompjuterizuara u shkri në Hyrje në Informatikë e cila do të përmbajë në vetvete edhe tematika të Llogaritje të kompjuterizuara. (Semestri I).
- Përpunim teksti riemërtohet si lëndë: Shkrim Akademik. (Semestri I).
- Shtohet lënda Statistikë e Aplikuar. (Semestri II).
- Lënda Përdorim dhe Administrim i sistemeve Ëindoës, u rikonsiderua si e parakohshme për një student të vitit të parë, semestri i parë, ndërkohë që ka nevojë të marrë konceptet e Sistemeve të Shfrytëzimit. Prandaj, lënda Sistemet e Shfrytëzimit, zhvendoset në Semestrin IV në mënyrë që studentët të mos kenë vështirësi kur të bëjnë Linux në semestrin V. Gjithashtu lënda Përdorim dhe Administrim i Sistemeve Ëindoës e përbërë nga dy module u shkri në një të vetme, Administrim i Sistemeve Ëindoës dhe u zhvendos në semestrin V.
- Në lëndën Programin të dhënash e përbërë nga dy module, Bazat e Programimit (Semestri I) dhe Programim në gjuhën C (Semestri II), u aplikua një ndryshim për modulën e dytë. Programim në gjuhën C zhvendoset në Semestrin e parë dhe riemërohet, Strukturë të dhënash në C.
- Lënda Bazë të dhënash, me të dy modulet e saj, që bëhet në semestrat I dhe II, shtyhet për në semestrin II me Hyrje në DB dhe semestrin III me SQL; në mënyrë që studenti të jetë më në gjendje të abstragojë dhe kuptojë queries, normalizimet, apo sintaksa të tjera të SQL.
- Lënda Rrjeta Kompjuterike me 3 module: Teori, Praktike dhe Administrim e Siguri Rrjetash zhvillohet në vitin e parë dhe të dytë. Dy modulet e parë bashkohen në një dhe lënda e re quhet Rrjeta Kompjuterike e zhvendosur në semestrin V. Ndërsa moduli i saj i tretë u riemërua si Siguria e Sistemeve të Informacionit (Semestri V) në mënyrë që të jetë



më e përgjithshme për sigurinë e informacionit dhe jo vetëm në rrjeta.

- Lënda Programim me 3 module riemërtohet si Programim i Avancuar, meqë 3 modulet e saj zhvillojnë teknologjitë .Net, Php dhe Oracle.
- Lënda Arkitektura Kompjuterike zhvendoset në semestrin III, para se të fillojnë lëndët e rëndësishme të programimit.
- Shtohet Lënda Menaxhim Projektesh (Semestri IV), për të patur një qasje më praktike dhe profesionale ndaj zhvillimeve në fushën e Teknologjisë.
- Moduli Implementime Multimediale për Ëeb i Lëndë me Formim Design, hiqet dhe lihet vetëm Përpunim Imazhi në atë semester që ishte (IV). Kjo për arsye se një pjesë e tematikave të modulit Implementime Multimediale për Ëeb mund të përfshihen të Lënda Ëeb Design. Gjithashtu përpunime multimediale zhvendoset nga Semestri V në Semestrin II.

Marrë të mirëqena këto ndryshime, shpërndarja dhe përqindja e krediteve sipas kategorive së lëndëve apo veprimtarisë është si mëposhtë:


Kategoritë	A	B	C	D	E
Total Kredite	33	100.5	10.5	30	6
Përqindja	18.33%	55.83%	5.83%	16.67%	3.33%

Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B është 74.16%.

Konkretisht më poshtë paraqitet një krahasim vizual (2022-2023 kundrejt ndryshimeve për 2023-2024) për lëndët/veprimtaritë të shoqëruara me nr. e krediteve dhe kategorinë përkatëse:

2022-2023				2023-2024			
2022-2023	Emërtimi	Kat ego ria	EC TS/ Tot al	2023-2024	Emërtimi	Ka teg ori a	E C TS /T ota l
Viti I Semestri I	NJOHURI INFORMATIKE DHE APLIKACIONE BAZË/ Hyrje në Informatikë	A	3	Viti I Semestri I	Hyrje në Informatikë	B	6
	NJOHURI INFORMATIKE DHE APLIKACIONE BAZË/ Përpunim Teksti	A	3		Shkrim Akademik	A	3
	PËRDORIM DHE ADMINISTRIM I SISTEMEVE	A	4.5		PROGRAMIM TË DHËNASH/Struktur e të dhenash në C	B	6

Semestr II	ËINDOËS/Përdorim i Sistemeve Operative		
	MATEMATIKË/Matematikë 1	A	4.5
	PROGRAMIM TË DHËNASH/ Bazat e Programimit	B	6
	BAZË TË DHËNASH/ Hyrje në Bazë të Dhënash	B	4.5
	GJUHË E HUAJ-ANGLISHT/ Anglisht 1	D	3
	GJUHË E HUAJ-GREQISHT/Greqisht 1	D	1.5
			30
	NJOHURI INFORMATIKE DHE APLIKACIONE BAZË/ Llogaritje të Kompjuterizuara	A	4.5
	PËRDORIM DHE ADMINISTRIM I SISTEMEVE ËINDOËS/Administrim i Sistemeve Ëindoës	A	4.5
	MATEMATIKË/Matematikë 2	A	4.5
	PROGRAMIM TË DHËNASH/ Programim në Gjuhën C	B	6
	BAZË TË DHËNASH/ SQL	B	4.5
	GJUHË E HUAJ-ANGLISHT/ Anglisht 2	D	3
	GJUHË E HUAJ-GREQISHT/Greqisht 2	D	3
			30



Semestr II	MATEMATIKË/Matematikë 1	A	4.5
	PROGRAMIM TË DHËNASH/ Bazat e Programimit	B	6
	GJUHË E HUAJ-ANGLISHT/ Anglisht 1	D	3
	GJUHË E HUAJ-GREQISHT/Greqisht 1	D	1.5
			30
	Statistike e Aplikuara	A	6
	PROGRAMIM I ORIENTUAR ME OBJEKTE NË C++/Programim i Orientuar në objekte në C++	B	6
	MATEMATIKË/Matematikë 2	A	4.5
	BAZË TË DHËNASH/Hyrje në DB	B	4.5
	Perpunime multimediale	A	3
	GJUHË E HUAJ-ANGLISHT/ Anglisht 2	D	3
	GJUHË E HUAJ-GREQISHT/Greqisht 2	D	3
			30



Viti II			Viti I	60
Semestri III	PROGRAMIM I ORIENTUAR ME OBJEKTE NË C++/Programim i Orientuar me objekte në C++	B	6	
		B	4.5	
		C	4.5	
		B	6	
		C	3	
		D	3	
		D	3	
				30
	Semestri IV	B	6	
		C	3	
		C	6	
		B	6	
		C	4.5	

Viti I			Viti I	60
Semestri III	Arkitekture Kompjuterike	B	6	
		B	6	
		B	6	
		B	6	
		D	3	
		D	3	
				30
	Semestri IV	B	6	
		D	3	
		B	6	
		B	6	
		C	4.5	



Viti III		GJUHË E HUAJ - ANGLISHT/Anglish t IV	D	3	
		GJUHË E HUAJ - GREQISHT /Greqisht IV	D	1.5	
				30	
	Semestri V	Viti II			60
		LINUX/Hyrje në Linux	B	3	
		PËRPUNIME MULTIMEDIALE/P ërpunime multimediale	A	3	
		PROGRAMIM/Programim në VB.Net	B	6	
		SISTEME SHFRYTËZIMI	B	6	
		ANALIZË TË DHËNASH	B	6	
		ARKITEKTURA X86 GJUHA ASSEMBLER/Arkit ektura X86 Gjuha Assembler	B	6	
				30	
		PROGRAMIM/Programim në Ëeb me PHP	B	6	
		PROGRAMIM/Programim në Oracle	B	6	
		Semestri VI	LINUX/ Linux i Avancuar	B	6
			Praktika Profesionale	D	6
Diploma	E		6		
			30		
Viti III			60		

		GJUHË E HUAJ - ANGLISHT/Anglish t IV	D	3
		GJUHË E HUAJ - GREQISHT /Greqisht IV	D	1.5
				30
	Semestri V	Viti II		60
		Siguria ne sistemet e informacionit	B	6
		PROGRAMIM I AVANCUAR/Progr amim në VB.Net	B	6
		ANALIZË TË DHËNASH	B	6
		Administrimi i sistemeve Ëindoës	A	6
		Rrjeta Kompjuterike	C	6
	Semestri VI			30
		PROGRAMIM I AVANCUAR/Progr amim në Ëeb me PHP	B	6
		PROGRAMIM I AVANCUAR/Progr amim në Oracle	B	6
		Linux	B	6
		Praktika Profesionale	D	6
		Diploma	E	6
				30
		Viti III		60

	Total viti I + II +III		180

	Total viti I + II +III		180

Programi i studimit Bachelor në Informatikë e Zbatuar është në një proces përmirësimi për të përmbushur e respektuar standardet e përcaktuara si dhe për të kontribuar për Institucionin tonë në mënyrë që të reflektohet më së miri ndërtimi dhe promovimi i eksperiencës, dijeve dhe vlerave profesionale e njerëzore.

Përgjegjësi i Departamentit:
Esmeralda Kadëna, Ph.D.




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDACIONI “LOGOS”
KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”**



**RAPORT VJETOR
PËR
VEPRIMTARINË E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË
TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”
PËR VITIN AKADEMIK
2023-2024**



Shtator, 2024

Pasqyra e Lëndës

HYRJE	3
PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	4
Akreditimi Periodik	4
Përmbushja e Rekomandimeve të Vendimeve të Bordit të Akreditimit	5
Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për Akreditim	5
Veprimtaria e Vazhdueshme	5
Aktivitete Informuese	6
Aktivitete Vlerësuese	6
PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	21

HYRJE

Kolegji Universitar “LOGOS” ka hartuar politika, ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, Neni 103, pika 1 dhe në aktet rregullatore të brendshme, Kolegji Universitar “LOGOS” ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përherëshëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në nivel institucioni, veprimtaria e të cilave mbështetet në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. Si përmbushje e objektivit 2 të prioritetit strategjik 6: Sigurimi i Cilësisë, i evidentuar nga Kolegji Universitar “LOGOS” në planin e tij strategjik, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet me qëllim përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë. Ky sistem ndjek, vlerëson dhe monitoron procesin e mësimdhënies dhe koordinon e bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet për arritjen e një cilësie të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Pjesë e anëtarësisë në të dyja strukturat, është edhe përfaqësuesi i trupës studentore me një rol aktiv në proceset e cilësisë.

Veprimtaria për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” udhëhiqet nga Politika për Sigurimin e Cilësisë e hartuar në përputhje me Kodin e Cilësisë, siç udhëzon pika 5 e nenit 103 të Ligjit nr 80/2015 dhe i referohet një procesi të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi dhe përmirësimi të cilësisë së kolegjit e programeve që ai ofron duke u bazuar në kritere të brendshme e të jashtme. Menaxhimi i cilësisë, rritja e cilësisë, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i cilësisë, janë mjete nëpërmjet të cilave sigurohet cilësia në institucion. Sigurimi i cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” ka tre qëllime kryesore: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si pjesë e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, krijon, pasuron dhe mirëmban sistemin e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm dhe në bazë të rezultateve të monitorimeve të kryera, përgatit raporte të cilat u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera përdoren për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë paraqet raportin për veprimtarinë e kryer gjatë vitit akademik 2023-2024 sipas Rregullore së Sigurimit të Cilësisë (Kreu III, Neni 16, pika x).

Raporti përmban:

1. informacion të përmbledhur për veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj;
2. informacion për veprimtarinë e njesisë në përmbushje të objektivave të saj vjetore bazuar në zbatim të Politikave për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”;
3. informacion për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies (për semestrin e I-rë dhe të II-të) dhe për vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”;
4. mendime dhe rekomandime.

Raporti vjetor i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është hartuar bazuar në veprimtarinë e saj dhe të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë, Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe njësitë bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë (*Kreu III, Neni 16, pika 2*), në përmbushje të misionit të saj, për planifikimin, drejtimin, organizimin dhe publikimin e veprimtarisë së kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimit të Kolegjit Universitar “LOGOS” për krijimin e kulturës së cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), argumenton në mënyrë të përmbledhur realizimin e objektivave vjetore për vitin akademik 2023-2024:

Akreditimi Periodik

1. Në përmbushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/d:
 - A. NJSBC në kuadër të akreditimit periodik të programeve të ciklit parë dhe të dytë:
 - B. Master Profesional në Theologji Praktike dhe Sociale
 - Bachelor në "Financë- Kontabilitet"
 - Bachelor në "Punë Sociale"
 - Program profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
 - Master i Shkencave në "Përkthim Profesional"

ka planifikuar e menaxhuar vlerësimin e brendshëm duke suportuar GVB-të përkatëse me asistencë teknike për kryerjen e vetëvlerësimit sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë dhe duke bashkëpunuar me ASCAL për vlerësimin e jashtëm të këtyre programeve.

Përmbushja e Rekomandimeve të Vendimeve të Bordit të Akreditimit

- C. NJSBC ka monitoruar planin e veprimit të institucionit në përmbushje të rekomandimeve në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit (Nr. 58, datë 16.12.2021, “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, Kolegji Universitar “Logos”) dhe ka bashkëpunuar me strukturat përkatëse për përmbushjen e këtij plani.

Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për Akreditim

- D. Sipas planit të veprimtarisë të saj, NJSBC ka planifikuar vlerësimin e brendshëm gjatë vitit akademik 2023-2024 të programeve të studimit të ciklit parë dhe të dytë:
- Master Profesional në Theologji Praktike dhe Sociale
 - Bachelor në "Financë- Kontabilitet"
 - Bachelor në "Punë Sociale"
 - Program profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
 - Master i Shkencave në "Përkthim Profesional"

duke asistuar në punën përgatitore të njësive bazë për procesin e vlerësimit të brendshëm dhe duke njohur strukturat e përfshira në këtë proces me modelin e ri të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bazuar në Kodin e ri të Cilësisë së Arsimit të Lartë (miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021).

Veprimtaria e Vazhdueshme

2. *Përmbushjen e përgjegjësisë të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/j*, për vlerësimin e ecurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”, NJSBC e ka kryer nëpërmjet bashkëpunimit përkatësisht me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe me njësitë bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS” duke përdorur metoda e instrumente të drejtëpërdrejta e të tërthorta vlerësimi, si:
- pyetësorë të studentëve në fund të çdo semestri për cilësinë e mësimdhënies dhe veprimtarinë e departamentit
 - të dhëna nga studentë të diplomuar, aktivë në tregun e punës anëtarë të LOGOS Alumni;
 - të dhëna nga analiza e punës së departamenteve
 - mendimin e ekspertëve të jashtëm të fushës gjatë proceseve të akreditimeve të mëparshme të programeve të studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”.

Rezultatet e këtyre monitorimeve janë pasqyruar në raportet vjetore të njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Aktivitete Informuese

3. *Bazuar në Nenin 16, pika 3/l të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë*, NJSBC ka organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët e Kolegjit Universitar “LOGOS” për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet:
 - Zhvillimit të seancave të informimit të studentëve mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, treguesit e përdorur e mënyra e interpretimit të tyre;
 - Trajnimit të stafit të ri akademik të përfshirë në strukturat e sigurimit të cilësisë për përfitimin e përvojës në këtë drejtim me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë gjithmonë e më të gjerë në institucion.

Aktivitete Vlerësuese

4. *Në përmbushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/h & i*, NJSBC në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies nga studentët dhe në fund të vitit akademik, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e veprimtarisë së njësive bazë dhe të shërbimeve për studentët duke përdorur paketën e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë të miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” bazuar në manualin e Cilësisë (sipas Kreut IV/*Procedura të sigurimit të cilësisë, Neni 24/Inicimi i vlerësimit*).

Në zbatim të Nenit 27 të Rregullores/*Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit*, NJSBC ka mbikëqyrur procesin për komunikimin dhe publikimin e vlerësimit, me qëllim garantimin se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë të jetë i përshtatshëm për qëllimin që ka, i arritshëm e i besueshëm.

Për këtë qëllim, janë hartuar raporte semestrale adresuar Rektorit të Kolegjit Universitar “Logos” dhe gjithashtu Kryetarit të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe drejtuesve të njësive bazë në të cilat pasqyrohet qartë metodologjia e vlerësimit, matësit e përdorur, rezultatet e pritshme e interpretimi i tyre dhe sigurisht rezultatet e vlerësimit.

Në këto raporte evidentohen krahasimet e rezultateve semestrale për cilësinë e mësimdhënies ose krahasim në bazë vjetore për vlerësimin e veprimtarisë së departamenteve; evidentohen sugjerimet objektive të studentëve; adresohen mangësitë e evidentuara dhe sugjerohen masat e nevojshme që duhet të merren në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Këto raporte janë përdorur për përmirësimin e performancës së personelit akademik sipas Nenit 28/ *Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit*.

Reflektimi mbi sugjerimet e dhëna nga këto raporte, janë shprehur përmes:

- trajnimeve të stafit akademik nga ekspertë të huaj e profesorë të Universiteteve partnere për metodat e mësimdhënies dhe organizimin e simpoziumeve shkencore me fokuse edukimin;

- mbështetjes së stafit për rritjen e formimit të tyre akademik e shkencor;
- rritjes së numrit të mobiliteteve të stafit akademik në universitet partnere në kuadër të programit Erasmus+, etj.

Informacion për vlerësimin e pyetësorëve

Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies në Semestrin e I-rë të vitit akademik 2023-2024

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj, si dhe të objektivave të parashikuara për kryerjen e veprimtarive monitoruese, vlerësuese e përmirësuese si një mënyrë e garantimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” bazuar në Kreun III, Nenin 16 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, ka organizuar e monitoruar procesin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët, për lëndët e semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024.

Ky proces u iniciua me shpërndarjen e formularëve, pjesë e paketës së intrumenteve të miratuar nga Senati Akademik i KU “LOGOS” bazuar në manualin e Cilësisë (sipas Kreut IV/Procedura të sigurimit të cilësisë, Neni 24/Inicimi i vlerësimit).

Pasi u përgatitën formularët e vlerësimit për çdo pedagog, efektiv e të ftuar, të angazhuar në programet e ofruara nga KU “LOGOS” (çdo pedagog është vlerësuar në të gjitha lëndët që mbulon), të cilat u postuan në klasat përkatëse të administruar nga IT në Microsoft Teams (sipas programeve e viteve të studimit).

Ky proces u realizua në nisjen e javës së XIV dhe në përfundim të javës së XV të semestrit të parë.

U monitorua vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në këtë proces dhe u ndërmorën disa masa nga ana e NJSBC-së për të siguruar një pjesëmarrje sa më të lartë të studentëve. Për këtë qëllim, është kryer një komunikim i drejtpërdrejtë me studentët për të evidentuar problematika të mundshme si p.sh. mosaksesimi i llogarive në Microsoft Teams për plotësimin e formularëve, apo moskuptimi i pyetjeve të përfshira në formular për një vlerësim sa më objektiv. Si pasojë, u resetuan nga IT një numër i konsiderueshëm i llogarive të studentëve të evidentuar me këtë problematikë.

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit sipas secilit grup mësimor ishte:

Për Fakultetin Ekonomik:

Bachelor në Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizëm	
Viti i parë	– u përgatitën 8 formularë për 8 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 4 për secilin pedagog (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 66.6%.</i> Vlerësimet ishin mbi 4.0, sugjerime nuk kishte
Viti i dytë	– u përgatitën 8 formularë për 8 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 2 për secilin pedagog (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 28.6%.</i> Vlerësimet ishin nga 3.5-3,68 për 3 pedagogë, të tjeret vlerësimi ishte mbi 4.0
Viti i tretë:	Bachelor në Financë-Kontabilitet – u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin rreth 1.5 studentë për pedagog (në total të regjistruar 8 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 13%.</i> Vlerësimi ishte mbi 4.5, sugjerime nuk ka. Bachelor në Menaxhim Turizëm – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 2 për pedagog (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 33.3%.</i> Vlerësimi mesatarisht është 5.0 me përjashtim të një pedagogu me vlerësim 3.5 për këtë pedagog ka një sugjerim nga studentët lidhur me sjelljen. Bachelor në Menaxhim Biznes – u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 3 studentë për pedagog (në total të regjistruar 10 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 40%.</i> Vlerësimi është maksimal me 5.0, me përjashtim të një pedagogu me 3.5.
Master Profesional në Financë-Kontabilitet	
U përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 10 studentë (aktivë))	<i>Pjesëmarrja afërsisht 40%.</i> Vlerësimi ishte maksimal me 5.0 pikë.
Nga ndjekja e procesit të vlerësimit të pedagogëve, u vunë re disa problematika:	
- Mosangazhimi i studentëve në plotësimin e formularëve - Një pjesë e studentëve raporton vështirësi në aksesim të programit “Microsoft Teams” (sidomos Viti I Pare) .	
Për orientimin e këtij procesi janë angazhuar stafi akademik sipas viteve, në këtë drejtim kanë punuar dhe anëtarët e NJSBC-së si dhe vetë Përgjegjësat e Departamenteve.	
Ajo që konstatohet vit pas viti nga ky proces është ngurimi që kanë studentët lidhur me anonimin, për të cilin ne kemi punuar shumë duke i sqaruar dhe bindur se ky problem nuk ekziston.	

Është konstatuar një lloj neglizhence dhe indiferentizmi tek studentët për pjesëmarrjen në proces.

Ka një pjesëmarrje të ulët të studentëve në plotësimin e formulareve, mbi zhvillimin e procesit mësimor gjatë semestrit, kjo është shprehur më shumë tek studentët e vitit të II dhe të III.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika madhore të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të Fakultetit Ekonomik. Vlen të përmendet fakti se të gjithë pedagogët janë vlerësuar me një koeficient mbi 4.

Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët e Fakultetit Ekonomik. Studentët kanë shprehur konsideratë veçanërisht për stafin akademik të angazhuar pranë këtij Fakulteti. Problematikë, edhe në krahasim me vitin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në përfshirjen në procesin e plotësimit të pyetësorëve.

**Program profesional 2-vjeçar në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe
“Marketing i produktit bujqësor”**

Viti I – u përgatitën 9 formularë për 9 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 1 për pedagog (në total të regjistruar 1 studentë). ***Pjesëmarrja afërsisht 100%.***

Viti II – u përgatitën 7 formularë për 7 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 7 studentë). ***Pjesëmarrja afërsisht 29%.***

Për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara:

Bachelor në Informatikë e Zbatuar

Viti i parë - u përgatitën 8 formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 5 studentë për pedagog (në total të regjistruar 11 studentë). ***Pjesëmarrja afërsisht 63.6%.*** Vlerësimi është maksimal.

Viti i dytë - u përgatitën 8 formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 9 studentë). ***Pjesëmarrja afërsisht 44.4%.*** Vlerësimi është maksimal, sugjerime nuk ka

Viti i tretë - u përgatitën 6 formularë vlerësimi për 6 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 7 për pedagog (në total të regjistruar 19 studentë). ***Pjesëmarrja afërsisht 36.8%.*** Vlerësimi është mbi 4.0 pikë, sugjerohet të zhvillohen më shumë seminare

Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore	
Viti i parë - u përgatitën 8 formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 9 për pedagog (në total të regjistruar 20 studentë). Pjesëmarrja afërsisht 45%. Vlerësimi është rreth 5.0, sugjerohet nga 1 student, për 2 lëndë të reduktohet programi i mësimi	
Viti i dytë - u përgatitën 9 formularë vlerësimi për 9 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 25 studentë). Pjesëmarrja afërsisht 16%. Vlerësimi është rreth 5.0, ka sugjerim vetëm nga një student..	
Viti i tretë - u përgatitën 9 formularë vlerësimi për 9 pedagogë dhe numri i studentëve që ishte mesatarisht 6 për pedagog (në total të regjistruar 35 studentë). Pjesëmarrja afërsisht 17.1%. Vlerësimi është rreth 5.0.	
Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore	
U përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 16 studentë). Pjesëmarrja afërsisht 25%. Sugjerime nuk ka. Nga ndjekja e procesit të vlerësimit të pedagogëve, u vunë re disa problematika: - Mosangazhimi i studentëve në plotësimin e formularëve - Një pjesë e studentëve raporton vështirësi në aksesim të programit “Microsoft Teams” (sidomos Viti I Pare) Për orientimin e këtij procesi janë angazhuar stafi akademik sipas viteve, në këtë drejtim kanë punuar dhe anëtarët e NJSBC-së si dhe vetë Përgjegjësat e Departamenteve. Ajo që konstatohet vit pas viti nga ky proces është ngurimi që kanë studentët lidhur me anonimin, për të cilin ne kemi punuar shumë duke i sqaruar dhe bindur se ky problem nuk ekziston. Është konstatuar një lloj neglizhence dhe indiferentizmi tek studentët për pjesëmarrjen në proces. Ka një pjesëmarrje të ulët të studentëve në plotësimin e formulareve, mbi zhvillimin e procesit mësimor gjatë semestrit, kjo është shprehur më shumë tek studentët e vitit të II dhe të III. Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika madhore të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Vlen të përmendet fakti se të gjithë pedagogët janë vlerësuar me një koeficient mbi 4.	

Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Studentët kanë shprehur konsideratë veçanërisht për stafin akademik të angazhuar pranë këtij Fakulteti. Në vitin e parë, nga një student, është propozuar që të rishikohet programi mësimor për dy lëndë, ndërsa në studimet master profesional, një student ka sugjeruar të rishikohet mundësia e zëvendësimit të pedagogut.

Problematikë, edhe në krahasim me vitin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në përfshirjen në procesin e plotësimit të pyetësorëve.

Për Fakultetin e Shkencave të Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor:

Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor
Viti I - u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 6 formularët kishte 2 vlerësime (në total të regjistruar 9 studentë). Pjesëmarrja rreth 25 % , vlerësimi ka qenë me pikë maksimale
Viti II - u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 7 formularët kishte 2 vlerësime (në total të regjistruar 7 studentë). Pjesëmarrja rreth 30 % , vlerësimi ka qenë me pikë maksimale 5.0.
Viti III - u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 7 formularët kishte 2 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). Pjesëmarrja rreth 40% , vlerësimi ka qenë me pikë maksimale rreth 5.0
Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 2 pedagogë dhe për 2 formularët kishte 3 vlerësime (në total të regjistruar 3 studentë). Pjesëmarrja 100 % . Vlerësimi ishte rreth 5.0.
Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 7 formularët kishte rreth 6 vlerësime (në total të regjistruar 3 studentë, por janë dhe 3 studentë që janë përsëritës). Pjesëmarrja 2 në 3 studentë .
Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencat Religjioze
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për 8 formularët kishte 0 vlerësime (në total të regjistruar 2 studentë).
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për të 7-të formularët kishte nga 3 vlerësim (në total të regjistruar 3 studentë). Pjesëmarrja 100% , vlerësimi ishte me pike maksimale rreth 5.0.

Viti i tretë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 8 pedagogë dhe për formularët kishte 0 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja 0%.</i>
Master Shkencor në Turizëm Religjioz
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 6 formularët kishte 0 vlerësime (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 0 %.</i>
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 7 pedagogë dhe për 7 formularët kishte 1 vlerësime (në total të regjistruar 2 studentë) ku një pedagog vlerësohet me 3,8 të tjerët me pikë maksimale. <i>Pjesëmarrja 1 në 2 studentë.</i>
Bachelor në Punë Sociale
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 5 formularët kishte 1 vlerësim (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja rreth 20%,</i> vlerësimi ka qenë mbi 4.8.
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 6 pedagogë dhe për 6 formularët kishte 3 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja 60 %,</i> vlerësimi është rreth 5.0 pikë.
Master i Shkencave në Përkthim Profesional
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 5 pedagogë dhe për 5 formularët kishte 4 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). <i>Pjesëmarrja 80 %,</i> vlerësimi është me pikë rreth 4.85.
Viti i dytë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 2 pedagogë dhe për 2 formularët kishte 1 vlerësime (në total të regjistruar 1 studentë). <i>Pjesëmarrja 100 %</i> vlerësimi është me pikë rreth 4.85.
Master Profesional në Theologji Praktike dhe Sociale
Viti i parë – u përgatitën formularët e vlerësimit për 5 pedagogë dhe për 5 formularët kishte 3 vlerësime (në total të regjistruar 5 studentë). Rreth 80 %,ku u vleresuan me pike maksimale rreth 5.0.

Nga ndjekja e procesit të vlerësimit të pedagogëve, u vunë re disa problematika:

- Mosangazhimi i studentëve në plotësimin e formularëve
- Një pjesë e studentëve raporton vështirësi në aksesim të programit “Microsoft Teams” (sidomos Viti I Pare) .

Për orientimin e këtij procesi janë angazhuar stafi akademik sipas viteve, në këtë drejtim kanë punuar dhe anëtarët e NJSBC-së si dhe vetë Përgjegjësat e Departamenteve.

Ajo që konstatohet vit pas viti nga ky proces është ngurimi që kanë studentët lidhur me anonimin, për të cilin ne kemi punuar shumë duke i sqaruar dhe bindur se ky problem nuk ekziston.

Është konstatuar një lloj neglizhence dhe indiferentizmi tek studentët për pjesëmarrjen në proces. Ka një pjesëmarrje të ulët të studentëve në plotësimin e formulareve, mbi zhvillimin e procesit mësimor gjatë semestrit, kjo është shprehur më shumë tek studentët e vitit të II dhe të III.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik.

Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika madhore të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Vlen të përmendet fakti se të gjithë pedagogët janë vlerësuar me një koeficient mbi 4.

Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar pozitivisht nga studentët e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Studentët kanë shprehur konsideratë veçanërisht për stafin akademik të angazhuar pranë këtij Fakulteti. Problematikë, edhe në krahasim me vitin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në përfshirjen në procesin e plotësimit të pyetësorëve.

Konkretisht NJSBC propozon:

- Bashkëpunim më të ngushtë me njësitë bazë me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e këtij procesi në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies dhe për rëndësinë që ka aksesimi i platformave zyrtare të vendosura nga KU “LOGOS” për komunikim zyrtar midis strukturave.

- Një trajnim të përgjithshëm të përfaqësuesve të studentëve në strukturat e ngritura nga NJSBC dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, si Këshilli Studentor, senatorët, etj;

- Rishikimin e formularëve me qëllim ristrukturimin e tyre (nëse është e mundur), në disa rubrika;

Sipas Nenit 27/Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit, procesi për komunikimin dhe publikimin e monitorimit, vlerësimit, është mbikqyrur nga NJSBC-ja me qëllim garantimin se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë të jetë i përshtatshëm për qëllimin që ka, i arritshëm e i besueshëm.

Komunikimi i rezultateve të vlerësimit është kryer nëpërmjet raporteve të monitorimit që u janë komunikuar organeve strukturave dhe autoriteteve përkatëse të KU LOGOS. Këto raporte përdoren për përmirësimin e performancës së personelit akademik sipas Nenit 28/Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit.

Gjithashtu, rezultatet e vlerësimit do t'i dërgohen elektronikisht, Rektorit të KU “Logos”, Përgjegjësve të Departamenteve si dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.

Informacion për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies në Semestrin e II-rë të vitit akademik 2023-2024 dhe për vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë të Kolegjit Universitar “LOGOS”

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përmbushje të misionit të saj, si dhe të objektivave të parashikuara për kryerjen e veprimtarive monitoruese, vlerësuese e përmirësuese si një mënyrë e garantimit të cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”, ka organizuar e monitoruar procesin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët, për lëndët e semestrit të dytë të vitit akademik 2023-2024 si dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësive bazë.

Pasi u diskutua mbi mundësinë e përmirësimit të instrumentit të përdorur për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies (diskutim i gjeneruar nga problematikat e hasura gjatë vitit të kaluar me vështirësinë e të kuptuarit të disa pyetjeve të pyetësorit kryesisht nga studentët e viteve të para), NJSBC nëpërmjet anëtarëve të saj përfaqësues të njësive kryesore të Kolegjit Universitar “LOGOS” shtroi për diskutim dhe ftoi drejtuesit e njësive për sugjerime të mundshme në përmirësim të instrumentit të përdorur. Pas diskutimeve, u vendos që të përdorej i njëjti instrument i miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe u sugjerua mundësia e trajnimit të studentëve për përmbajtjen e formularit vlerësues për cilësinë e mësimdhënies.

Procesi inicioi në javën e XIII-të të semestrit të dytë me përgatitjen e formularëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të veprimtarisë së departamenteve të Kolegjit Universitar “LOGOS” të cilat u postuan në klasat përkatëse në platformën Microsoft Teams. Vlerësimi u krye për çdo staf akademik efektiv e të ftuar në çdo lëndë në të cilat ata angazhohen.

U monitorua vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në këtë proces dhe u ndërmorën disa masa nga ana e NJSBC-së për të siguruar një pjesëmarrje sa më të lartë të studentëve nga na sasiore dhe cilësore për një vlerësim sa më real.

Në përgjigje të përmirësimit të problematikave të evidentuara në semestrin e parë, NJSBC u kujdes të informonte studentët mbi strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe veprimtarinë e tyre, për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në plotësimin e pyetësorëve si një mundësi për të dëgjuar zërin e tyre me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies e mësimxënies në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Studentët u ftuan të jenë sa më të sqartë, kritik dhe sigurisht objektiv në plotësimin e pyetjeve të pyetësorit duke theksuar se anonimati i çdo studenti është kusht themelor për mbarëvajtjen e procesit dhe u informuan për mënyrën e procedimit me procesin e marrjes së informacionit e përpunimit të tij në përmbushje të plotë të këtij kushti.

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit sipas secilit grup mësimor për vlerësimin e pyetësorëve të pedagogëve për cilësinë e mësimdhënies ishte:

Për Fakultetin Ekonomik:

Bachelor në Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizëm
Viti i parë – u përgatitën 9 formularë për 9 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 3 për pedagog (në total të regjistruar 17 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 18%.</i>
Viti i dytë – u përgatitën 6 formularë për 6 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 2 për pedagog (në total të regjistruar 14 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 15%.</i>
Viti i tretë: Bachelor në Financë-Kontabilitet – u përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për pedagog (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja 15%.</i> Bachelor në Menaxhim Turizëm – u përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 1 për pedagog (në total të regjistruar 6 studentë). <i>Pjesëmarrja 17%.</i> Bachelor në Menaxhim Biznes – u përgatitën 5 formularë për 5 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 2 për pedagog (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 23%.</i>
Master Profesional në Financë-Kontabilitet
U përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin mesatarisht 1 për pedagog (në total të regjistruar 10 studentë (aktivë)). Pjesëmarrja afërsisht 10%.
Programi Diplomë profesionale në Agrobiznes me profile “Menaxhim ferme” dhe “Marketing i produktit bujqësor”
Viti I – u përgatitën 3 formularë për 3 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin: 1 për pedagog (në total të regjistruar 2 studentë). <i>Pjesëmarrja 50%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara:

Bachelor në Informatikë e Zbatuar
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 11 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 36.3%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 7 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 5 për pedagog (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 55.5%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 3 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 7 për pedagog (në total të regjistruar 19 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 36.8%.</i>
Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
Viti i parë - u përgatitën formularë vlerësimi për 8 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 4 për pedagog (në total të regjistruar 20 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 20%.</i>
Viti i dytë - u përgatitën formularë vlerësimi për 9 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan formularët ishte mesatarisht 5 për pedagog (në total të regjistruar 25 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 20%.</i>
Viti i tretë - u përgatitën formularë vlerësimi për 9 pedagogë dhe numri i studentëve që plotësuan ishte mesatarisht 3 për pedagog (në total të regjistruar 35 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 8.57%.</i>
Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratore Mjekësore
U përgatitën 4 formularë për 4 pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe plotësimet ishin 6 (në total të regjistruar 16 studentë). <i>Pjesëmarrja 37.5%.</i>

Për Fakultetin e Shkencave të Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor:

Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor
Viti I - formularët janë plotësuar vetëm për 1 pedagog nga 9 student (në total të regjistruar 9 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 11.1%.</i>
Viti II - formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 7 studentë). <i>Pjesëmarrja afërsisht 28.57%.</i>

Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek
Viti i dytë - formularët janë plotësuar nga 3 studentë për 8 pedagogë (në total të regjistruar 3 studentë). Pjesëmarrja 100 %
Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencat Religjioze
Viti i dytë – formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 3 studentë). Pjesëmarrja 66.6%.
Master Shkencor në Turizëm Religjioz
Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 1 studentë (në total të regjistruar 1 studentë). Pjesëmarrja 100%.
Bachelor në Punë Sociale
Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 1 studentë (në total të regjistruar 5 studentë). Pjesëmarrja 20%.
Viti i dytë – formularët janë plotësuar nga 4 studentë (në total të regjistruar 5 studentë). Pjesëmarrja 80%.
Master i Shkencave në Përkthim Profesional
Viti i parë – formularët janë plotësuar nga 2 studentë (në total të regjistruar 5 studentë). Pjesëmarrja afërsisht 40%.
Viti i dytë – formularët janë plotësuar nga 1 studentë (në total të regjistruar 1 studentë). Pjesëmarrja afërsisht 100%.
Master Profesional në Theologji dhe praktikë sociale
Formular janë plotësuar nga 5 studentë. Në total janë regjistruar 5 studentë. Pjesëmarrja 100 % .

- Pjesëmarrja e studentëve në procesin e vlerësimit të veprimtarisë së departamenteve ishte:

Departamenti	Formularë të plotësuar	% e pjesëmarrjes
Departamenti Financë Kontabilitet	Bachelor: 6 formularë të plotësuar / 21 studentë gjithsej Master: 1 formularë të plotësuar / 10 studentë gjithsej	afërsisht 28,57% afërsisht 10 %
Departamenti i Menaxhimit	8 formularë të plotësuar / 21 studentë gjithsej	afërsisht 38,09%
Departamenti i Agrobiznesit	1 formularë të plotësuar / 3 studentë gjithsej	33,33%
Departamenti i Shkencave Mjekësore	Bachelor: 12 formularë të plotësuar / 80 studentë gjithsej Master: 4 formularë të plotësuar / 16 studentë gjithsej	afërsisht 15 % afërsisht 37,5 %
Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës	17 formularë të plotësuar / 39 studentë gjithsej	afërsisht 43,6%
Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë	9 formularë të plotësuar / 16 studentë gjithsej	afërsisht 56,25%
Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës	Bachelor: 2 formularë të plotësuar / 3 studentë gjithsej Master Turizem Religjuz: 1 formularë të plotësuar / 1 studentë gjithsej	afërsisht 66,67% afërsisht 100%

	Master Perkthim Profesional: 6 formularë të plotësuar / 6 studentë gjithsej	afërsisht 100%
--	---	----------------

Rezultatet e vlerësimit të kryer për çdo departament:

Ajo që u konstatua nga ky proces është se ekziston një pjesëmarrje e ulët e studentëve në disa programe, pavarësisht masave të marra nga ana jonë pas semestrit të parë.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika madhore të cilat kërkojnë ndërhyrje nga secili fakultet.

Departamenti Financë-Kontabilitet

Vlerësimi i Departamentit Financë-Kontabilitet ishte mjaft pozitiv dhe studentët kanë vlerësuar punën e bërë gjatë këtij viti akademik nga anëtarët e departamentit. Vlen të theksohet se vlerësimi i punës së departamentit ishte i lartë në të gjitha aspektet e evidentuara për vlerësim në pyetësor. NJSBC vlerëson se departamenti duhet të përmirësojë punën e tij në lidhje me mbështetjen e studentëve për praktikën profesionale dhe përmirësimin e saj si dhe të tërheqë mendimin e tyre për çështje të literaturës që përdoret në lëndë të ndryshme.

Zhvillimi i procesit mësimor u vlerësua pozitivisht nga studentët dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit. Studentët kanë shprehur konsideratë për stafin akademik efektiv dhe atë me kontratë. Problematikë, edhe në krahasim me semestrin e kaluar, mbetet interesi i dobët i studentëve të vitit të parë dhe të dytë në procesin e vlerësimit. Nga të gjithë formularët e analizuar, vetëm dy pedagog kanë pasur vlerësim lehtësisht më të ulët se koeficienti 4, por theksojmë se për disa disa pedagogë nuk ka asnjë vlerësim nga studentët.

Departamenti i Menaxhimit

Për Departamentin e Menaxhimit studentët kanë dhënë vlerësim pozitiv. Problematikë, edhe në krahasim me semestrin e kaluar, mbetet pjesëmarrja e ulët e studentëve të programit Menaxhim Biznesi. Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik, efektiv dhe me kontratë. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit. Kërkohet ndjekja më nga afër e aktivizimit të studentëve në procesin e vlerësimit me qëllim pasjen e një pjesëmarrjeje më të lartë dhe rezultateve më afër realitetit.

Departamenti i Agrobiznesit

Nuk është arritur të kryhet sipas parashikimeve vlerësimi për Departamentin e Agrobiznesit. NJSBC vlerëson se departamenti duhet të përmirësojë punën në lidhje me nxitjen e studentëve në plotësimin e pyetësorëve, pasi në të dy semestrat vihet re në pjesëmarrje e ulët.

Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës

Vlerësimi i Departamentit të Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës ishte pozitiv dhe studentët kanë vlerësuar punën e bërë gjatë këtij viti akademik nga stafi pedagogjik. Koeficienti i vlerësimit për të gjitha lëndët përfshirë programin, metodikën e mësimdhënies dhe punën praktike është mbi 4.5 nga 5. Nga analizimi i vlerësimit të pyetësorit, NJSBC sugjeron të punohet më tepër në drejtim të pjesëmarrjes së studentëve në procesin e vlerësimit me qëllim që t'i shërbejë më shumë rritjes së cilësisë së punës së kësaj njësie.

Programi i studimit Bachelor në Informatikë e Zbatuar është në një proces përmirësimi për të përmbushur e respektuar standardet e përcaktuara si dhe për të kontribuar për Institucionin tonë në mënyrë që të reflektohet më së miri ndërtimi dhe promovimi i eksperiencës, dijeve dhe vlerave profesionale e njerëzore. Nga ana e studentëve ka një vërejtje për pedagogun Robert Shagla për komunikimin e tij.

Departamenti i Shkencave Mjekësore

Në lidhje me Departamentin e Shkencave Mjekësore, NJSBC evidenton pjesëmarrjen e ulët të studentëve në procesin e vlerësimit, sidomos programi ‘Master Profesional në Teknikë e Lartë në laboratorë Mjekësorë’. Nga analizimi i formularëve të plotësuar, vlerësimi i punës së departamentit ishte mjaft pozitiv, me një koeficient mbi 4.7 nga 5 për të gjitha lëndët. NJSBC sugjeron të punohet më tepër në drejtim të ndërgjegjësimit të studentëve për rëndësinë e procesit të vlerësimit në shërbim të tyre. Zhvillimi i procesit mësimor është vlerësuar mjaft pozitivisht nga studentët pjesëmarrës në anketim dhe pa problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

Vlerësimi i punës së Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë ishte përgjithësisht pozitiv në të gjitha aspektet e evidentuara për vlerësim në pyetësor. Nga analiza e bërë vërehet një pjesëmarrje e ulët e studentëve në procesin e vlerësimit. Janë bërë përpjekje për të trajnuar dhe theksuar rëndësinë e procesit dhe ruajtjen e anonimatit të tyre gjatë këtij procesi.

Në lidhje me vlerësimet individuale të pedagogëve, vihet re që në përgjithësi studentët vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Procesi i vlerësimit nuk ka hasur problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës

Për Departamentin e Theologjisë dhe Kulturës studentët kanë vlerësuar pozitivisht punën e tij. Në fund të procesit të plotësimit të formularëve vërehet një pjesëmarrje e ulët e studentëve në këtë proces. Ajo që vërehet tek formularët e plotësuar është se shumica e studentëve kanë komentuar pozitivisht për secilin pedagog.

Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë

Edhe në këtë departament vërehet një pjesëmarrje jo e plotë në plotësimin e formularëve. NJSBC sugjeron të punohet më tepër në drejtim të ndërgjegjësimit të studentëve për rëndësinë e procesit të vlerësimit në shërbim të tyre. Nga analizimi i formularëve të plotësuar, vlerësimi i punës së departamentit ishte kryesisht pozitiv në të gjitha aspektet e evidentuara në pyetësor. Ndërsa përsa u përket vlerësimit të pedagogëve, spikasin vlerësime pozitive për përgatitjen e pedagogëve, materialin që u ofrojnë studentëve dhe komunikimin e mirë dhe të shëndetshëm që kanë ata me studentët. Nuk vërehen problematika specifike që kërkojnë vëmendjen e departamentit.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të monitorimit dhe analizës së veprimtarisë akademike dhe kërkimore gjatë periudhës raportuese, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) evidenton se Kolegji Universitar “LOGOS” ka shënuar përmirësime cilësore të konsiderueshme në disa aspekte të rëndësishme të funksionimit institucional dhe akademik.

Në mënyrë të veçantë, vërehet një rritje e ndjeshme në cilësinë dhe diversitetin e programeve të studimit të ofruara, të cilat janë përmirësuar në përputhje me proceset e rishikimit të kurrikulave, përditësimit të përmbajtjes së lëndëve dhe përfshirjes së elementeve bashkëkohore në përmbajtje që gjithashtu kanë ndikuar pozitivisht dhe në përmirësimin e rezultateve të të nxënës dhe në përputhshmërinë e programeve me kërkesat e tregut të punës.

Gjithashtu, gjatë këtij viti akademik është vënë re një rritje e numrit të publikimeve shkencore të stafit akademik në revista të indeksuara ndërkombëtarisht, duke dëshmuar një orientim më të fortë drejt zhvillimit të kulturës kërkimore dhe përfundimit të profilit shkencor të institucionit. Ky progres është reflektuar edhe në pjesëmarrjen aktive të pedagogëve në konferenca ndërkombëtare dhe në bashkëpunime ndëruniversitare. Në të njëjtën linjë, është evidentuar një rritje e përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore dhe aktivitete akademike të zhvilluara në bashkëpunim me stafin akademik. Kjo tregon një përmirësim në ndërveprimin mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe një angazhim më të madh të studentëve në procese që nxisin mendimin kritik dhe zhvillimin e kompetencave profesionale. Përmblodhtas, NJSBC vlerëson se performanca akademike dhe kërkimore e Kolegjit Universitar “LOGOS” ka njohur progres të qëndrueshëm gjatë vitit raportues, duke reflektuar përkushtimin institucional për ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve të cilësisë në të gjitha dimensionet e aktivitetit universitar.


Përpiloi raportin: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Dr. Jehona Germizi
Kryetare

Dr. Thoma SHKIRA
Anëtar



Prof. Asoc. Dr. Tefta Rota
Anëtar



Msc. Eleni Papapano
Anëtar

PËRFAQËSUESI I TRUPËS STUDENTORE
Denisa Palushi
Anëtar

